

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6111
E premte, 11 shtator 2020
çmimi 0.40 €

Departamenti Amerikan i Shtetit vlerëson lart sektorin financiar në Kosovë

FAQE 9



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PAS ARRITJES SË MARRËVESHJES NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË NË UASHINGTON, VETËVENDOSJA SHPREH PAKËNAQËSI

FAQE 4-5

SHBA-ja E KËNAQUR ME REZULTATET E DIALOGUT KOSOVË - SERBI



Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe Bashkimi Evropian (BE) janë shprehur të kënaqur me procesin e dialogut Kosovë - Serbi. Përfaqësuesi i posaçëm i Departamentit të Shtetit për Ballkanin Perëndimor, Matthew

Palmer, ka thënë të enjten se Uashingtoni është shumë i kënaqur me rezultatet bisedimeve dhe të marrëveshjes që është arritur më 4 shtator. E kënaqur me marrëveshjen dhe procesin e dialogut në kuadër të Brukselit

është shprehur edhe Qeveria e Kosovës, por jo edhe opozita. Lëvizja Vetëvendosje ka vlerësuar se marrëveshja e nënshkruar në Shtëpinë e Bardhë i ka sjellë shumë dëme Kosovës

Kosova dhe Shqipëria koordinohen për fuqizimin e sundimit të ligjit



Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, është takuar të enjten në Tiranë me homologen e vet, ministren Etilda Gjonaj, me të cilën ka diskutuar për bashkëpunimin bilateral në fushën e drejtësisë në mes të Kosovës dhe Shqipërisë. Ministri Selimi dhe ministrja Gjonaj gjatë këtij takimi diskutuan për ecurinë e reformave në drejtësi, për agjendën legjislative, për nismat për fuqizimin e luftës kundër korrupsionit në të dyja vendet dhe për forcimin e bashkëpunimit juridik

FAQE 3



Vazhdon trendi i rënies së rasteve të reja me Covid në Kosovë

FAQE 7

OPINION

NJË PORT SHQIPTAR DO TË BËHET DALJE E SHTETIT SERB NË ADRIATIK. A KA RËNË DAKORD QEVERIA E TIRANËS?

F. 11

Nga Bedri ISLAMI



AKTUALE

'KËRCËNON' ABAZOVIO: LARGHEM NGA QEVERIA NËSE INICIOHET TËRHEQJA E NJOHJES SË KOSOVËS

F. 2

MBYLLET ÇERDHJA PUBLIKE NË FUSHË-KOSOVË, SHKAKTAR COVIDI

F. 10

SHKK-ja TANI EDHE KATEGORI LIGJORE

F. 2

EKONOMI

APROVIMI I KREDIVE NGA BANKAT E KOSOVËS ARRIN NIVELE REKORDE QË NGA PASLUFTA

F. 5

OAK-u KËRKON NGA ATK-ja LEHTËSIM DHE MIRËKËPTIM PËR BIZNESET NË KOHË PANDEMIE

F. 8

SPORT

PRISHTINA BËN EDHE DY GODITJE TË MËDHA NË AFATIN KALIMTAR

F. 16



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

'Kërcënon' Abazović: Largohem nga qeveria nëse iniciohet tërheqja e njohjes së Kosovës

PODGORICË, 10 SHTATOR - Kryetari i Lëvizjes URA në Mal të Zi, Dritan Abazović, ka bërë një deklaratë kërcënuese se nuk rri në një qeveri në të cilën kërkohet tërheqja e njohjes së Kosovës. Sipas tij, nëse

iniciohet kjo gjë, ai largohet nga Qeveria, meqë pohon se për të qenë partnere qeverisëse, secili duhet t'i respektojë parimet. "Absolutisht do të dalim nga qeveria. Absolutisht largohem

nga një qeveri e tillë që inician diçka të tillë. Nëse vjen jashtë kësaj marrëveshje për t'u iniciuar, ne s'jemi më pjesë e qeverisë së Malit të Zi", ka thënë ai për televizionin "Klan Kosova".



Erdogani, bisedë telefonike me Thaçin dhe Vuçiqin



PRISHTINË, 10 SHTATOR - Presidenti turk Rexhep Tajip Erdoğan ka realizuar një bisedë telefonike me presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi. Ky lajm u bë me dije në një postim në rrjetin social "Twitter" nga zyra e presidencës turke. Në të njëjtin njoftim theksohet se Erdogan ka biseduar me

presidentin Thaçi, si dhe presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq. "Janë diskutuar zhvillimet rajonale dhe hapat që synojnë forcimin e marrëdhënieve Turqi - Kosovë dhe Turqi - Serbi. Presidenti Erdoğan u pajtua me presidentin Thaçi dhe presidenti Vuçiq për vazhdimin e bashkëpunimit

të ngushtë dhe konsultave për çështje bilaterale dhe regjionale", thuhet në njoftim. Erdoğan reagoi pas njohjes së Kosovës nga Izraeli. Ditë më parë Thaçi tha se është në kontakt me presidentin turk, Erdoğan dhe se kjo njohje s'do ta cenojë partneritetin miqësor e vëllazëror me Turqinë.

Pas tragjedisë me mbi 190 të vdekur, një zjarr i madh përfshin Portin e Bejrutit në Liban

BEJRUT, 10 SHTATOR - Një tjetër zjarr ka rënë në Portin e Bejrutit në Liban, e ngjarja ndodh pas tragjedisë në këtë vend, ku pati shpërthim më herët.

Zjarri shpërtheu në zonën e lirë të portit, ku gomat dhe vajrat ruheshin nga një kompani importuese, ka njoftuar drejtori i ngarkuar i portit, Bassem al-Kaissi, një stacion televiziv lokal. "Zjarri filloi në kanaçe vaji përpara

se të përhapet në goma", ka thënë ai, pa qenë në gjendje ta përcaktojë origjinën. "Zjarri mund të ketë ndodhur për shkak të një gabimi apo nxehtësisë", ka pohuar Kaissi. Kamionë të mbrojtjes civile u dërguan në vendin ku janë flakët, ndërsa ushtria vendosi helikopterë në përpjekje për ta shuar zjarrin.

Në mediat sociale, shumë video tregojnë një re të madhe zjarri dhe kolona të

trasha tymi të zi. Incidenti i së enjtes ua kujtoi libanezëve ditën fatale të 4 gushtit, kur shpërtheu një sasi e madhe e nitratis të amonit të ruajtur në një depo në port. Tragjedia, tepër e madhe për libanezët e vendosur, e gjunjëzuar nga një krizë e rëndë ekonomike, ka lënë të paktën 190 të vdekur dhe më shumë se 6 500 të plagosur, duke shkatërruar të gjithë rrethinat e Bejrutit.



Covid-19, gjysma e japonezëve ndihen më mirë pas pandemisë



TOKIO, 10 SHTATOR - Pothuajse gjysma e popullsisë së Japonisë thotë se ndihet në gjendje më të mirë pas pandemisë për shkak të masave paraprake të marra gjatë urgjencës shëndetësore dhe përmirësimit të përgjithshëm të mënyrës së jetesës, sipas një

sondazhi online të grupit "Meiji Yasuda", i cili intervistoi 5 640 persona, 48,1 për qind e të cilëve thonë se ndihen "më të shëndetshëm" ose "më mirë" duke ndjekur rekomandimet për të qëndruar në shtëpi. Studimi zbulon se te shumë persona është përmirësuar stili

i jetesës. Anketa e kryer në gjysmën e parë të gushtit ekzaminoi burra dhe gra të martuar midis moshës 20 dhe 79 vjeç.

Arsyet e këtyre ndryshimeve të favorshme pjesërisht i kushtohen kujdesit ndaj shëndetit, koha kushtuar

gjimnastikës, ulja e stresit dhe rënia e konsumit të pijeve alkoolike. Deri më sot infeksionet e koronavirusit në Japoni janë në nivele më të ulëta se mesatarja e vendeve perëndimore, me një total prej 73 545 rastesh dhe 1 411 vdekjet e konfirmuara.

Kosova dhe Shqipëria koordinohen për fuqizimin e sundimit të ligjit

Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, është takuar të enjten në Tiranë me homologen e vet, ministren Etilda Gjonaj, me të cilën ka diskutuar për bashkëpunimin bilateral në fushën e drejtësisë në mes të Kosovës dhe Shqipërisë. Ministri Selimi dhe ministrja Gjonaj gjatë këtij takimi diskutuan për ecurinë e reformave në drejtësi, për agjendën legislative, për nismat për fuqizimin e luftës kundër korrupsionit në të dyja vendet dhe për forcimin e bashkëpunimit juridik

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

HIRANË, 10 SHTATOR - Në kuadër të vizitës zyrtare në Republikën e Shqipërisë, ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, është takuar me homologen e vet, ministren Etilda Gjonaj, me të cilën kanë diskutuar për bashkëpunimin bilateral në fushën e drejtësisë në mes të Kosovës dhe Shqipërisë. "Ndjenjë e veçantë të qëndroj për vizitë zyrtare sot në Republikën e Shqipërisë në cilësinë e ministrit të Drejtësisë së Kosovës. Posaçërisht më gëzon fakti se mund të bëjmë së bashku gjëra të mira për kombin, për dy shtetet tona pro-perëndimore, me orientim të qartë euroatlantik, për fuqizimin e sundimit të ligjit si bazë e

integritimit evropian", ka thënë Selimi.

Ministri Selimi dhe ministrja Gjonaj gjatë këtij takimi diskutuan për ecurinë e reformave në drejtësi, për agjendën legislative, për nismat për fuqizimin e luftës kundër korrupsionit në të dyja vendet, për forcimin e bashkëpunimit juridik, si dhe për këmbimin e përvojave në aspektet pozitive për të përfituar sa më shumë nga praktikat e mira të njëra-tjetrës për konsolidimin e sistemit të drejtësisë në përgjithësi. "Republika e Kosovës dhe Republika e Shqipërisë sa i përket fushës së bashkëpunimit juridik tashmë në fushën penale kanë të nënshkruara marrëveshje për ekstradim, ndihmë të ndërsjellë juridike në çështje

penale, si dhe transferimin e personave të dënuar. Pra, fusha e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve sa iu përket çështjeve penale është e mbuluar dhe funksionon përgjithësisht mirë", ka deklaruar ministri Selimi.

Ndër të tjera, gjatë takimit dy ministrat diskutuan edhe për marrëveshjen për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet civile dhe tregtare, e cila do të nënshkruhet në mbledhjen e dy qeverive që do të mbahet së

shpejti, për adresimin e llogaridhënies dhe luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar. "Kemi folur edhe për një nga betejat më të rëndësishme, luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, si themele për shtetet tona dhe për imazhin e tyre në rrjedhat globale, për të cilën u pajtuam se duhet qasje e guximshme dhe ndërtimi i politikave të reja, për të dëshmuar një vullnet të ri për të ecur

përpara, me synimin për të hapur perspektiva të reja për zhvillimin e vendeve tona dhe për përshpejtimin e procesit të integritimit në familjen evropiane", ka thënë ministri Selimi.

Ndërsa ministrja Gjonaj falënderoi ministrin Selimi dhe shprehu gatishmërinë që përmes ekspertëve të Republikës së Shqipërisë të ndihmohet Kosova gjatë reformës së sistemit të drejtësisë.

ShKK-ja tani edhe kategori ligjore

PRISHTINË, 10 SHTATOR (ER) - Nën udhëheqjen e drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, Nehat Thaçi, pas një pune të gjatë dhe tejet dinamike, grupi punues ka përfunduar punën duke e hartuar Projektligjin e Shërbimit Korrektues të Kosovës (ShKK).

Në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, Grupi Punues për Hartimin e Projektligjit të Shërbimit Korrektues të Kosovës ka përfunduar hartimin e Projektligjit për Shërbimin Korrektues të Kosovës. I tërë aktiviteti i grupit punues ishte në funksion të plotë të përmbushjes së obligimeve, të cilat dalin nga Plani i Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2020-2021 dhe Programi Legjislativ për vitin 2020.

Më 28 korrik është themeluar ekipi punues për hartimin e projektligjit, në të cilin ishin të përfshirë përfaqësues nga: International Criminal Investigative Training Assistance Program (ICITAP),



Departamenti Ligjor i Ministrisë së Drejtësisë, Shërbimi Korrektues i Kosovës, Departamenti për Integritim Evropian MD, Sindikata e Shërbimit Korrektues e

Kosovës, përfaqësues të Institucionit të Avokatit të Popullit, EULEX-it, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, Organization for Security and Cooperation in

Europe (OSBE), Kryqi i Kuq Ndërkombëtar, si dhe përfaqësues nga Shoqata e Grave të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Shërbimi Korrektues i Kosovës

me këtë Projektligj synon që t'i arrijë objektivat e saj me qëllim të avancimit dhe zhvillimit të Shërbimit Korrektues të Republikës së Kosovës si një mekanizëm i rëndësishëm në kuadër të sistemit të drejtësisë së Republikës së Kosovës.

Shërbimi Korrektues i Kosovës vlerëson se rregullimi i f u s h ë v e p r i m t a r i s ë, kompetencave, organizimit të brendshëm, reformimi dhe avancimi sa më lart i Shërbimit Korrektues të Republikës së Kosovës është njëkohësisht në funksion të krijimit të kushteve për trajtimin e të burgosurve sipas standardeve vendore dhe ndërkombëtare.

Përmes këtij rregullimi ligjor, po ashtu synohet të ketë efekt edhe për ngritjen e besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë, veçanërisht në ShKK si një ndër institucionet me rëndësi vitale për korrektimin dhe risocializimin e të burgosurve që të njëjtët, pas përfundimit të burgut, t'i kthehen familjes dhe shoqërisë si qytetarë të dobishëm.



VAZHDOJNË REAGIMET PAS ARRITJES SË MARRËVESHJES SË UASHINGTONIT
NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË

SHBA-ja E KËNAQUR ME REZULTATET E DIALOGUT KOSOVË - SERBI

Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe Bashkimi Evropian (BE) janë shprehur të kënaqur me procesin e dialogut Kosovë - Serbi. Përfaqësuesi i posaçëm i Departamentit të Shtetit për Ballkanin Perëndimor, Matthew Palmer, ka thënë të enjten se Uashingtoni është shumë i kënaqur me rezultatet e atyre bisedimeve dhe marrëveshjes që është arritur më 4 shtator. E kënaqur me marrëveshjen dhe procesin e dialogut në kuadër të Brukselit është shprehur edhe Qeveria e Kosovës, por jo edhe opozita. Lëvizja Vetëvendosje ka vlerësuar se marrëveshja e nënshkruar në Shtëpinë e Bardhë i ka sjellë shumë dëme Kosovës

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Zëvendësndihmëssekretari amerikan i Shtetit, njëherësh përfaqësues i posaçëm i Departamentit të Shtetit për Ballkanin Perëndimor, Matthew Palmer, ka deklaruar se Uashingtoni është i lumtur me atë që po ndodh në negociatat midis Prishtinës dhe Beogradit.

Gjatë vizitës në Mostar të Bosnje dhe Hercegovinës, ai ka deklaruar se ShBA-ja është e

kënaqur me rezultatin e këtyre bisedimeve dhe marrëveshjen e Uashingtonit. "Sot unë jam në Mostar për të diskutuar se çfarë po ndodh këtu. Shtetet e Bashkuara janë me të vërtetë shumë të lumtura për bisedimet midis Kosovës dhe Serbisë dhe Uashingtoni është shumë i kënaqur me rezultatet e atyre bisedimeve dhe marrëveshjeve që janë arritur", ka deklaruar Palmer. Edhe BE-ja është shprehur e kënaqur me dinamikën e këtij procesi.

Zëdhënës i Bashkimit Evropian

për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Peter Stano, ka paralajmëruar mundësinë që Kosova dhe Serbia të diskutojnë edhe për çështjet për të cilat palët kanë arritur pajtim qysh në fazat e mëhershme të bisedimeve. Sipas tij, Kosova dhe Serbia duhet të merren me aranzhimet për komunitetet. "Si pjesë e bisedimeve për një marrëveshje gjithëpërfshirëse, tash është me rëndësi thelbësore që (Kosova dhe Serbia) të merren edhe me aranzhimet gjithëpërfshirëse



e kësaj marrëveshje është ajo ekonomike. “E para është pjesa ekonomike, janë projektet infrastrukturore, të dizajnuara kryesisht nga Ministria e Infrastrukturës dhe ajo e Ekonomisë dhe Ambientit, që në total shkojnë në një miliard dollarë investime, e që përfshijnë: autostradën Prishtinë-Merdar, hekurudhën Prishtinë-Merdar, studimin e fizibilitetit për hekurudhën që e lidh Prishtinën me Detin Adriatik, mbështetje financiare për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, investime në energjetikë përmes sjelljes së gazit në Prishtinë, termocentrale me gaz dhe rrjetin e shpërndarjes së gazit në Kosovë”, ka deklaruar Hoti. Në përgjithësi marrëveshjen e kanë përkrahur edhe dy partnerët e tjerë të koalicionit, Nisma dhe AAK-ja, ndonëse kjo e fundit i ka shprehur disa kritika për disa pika të marrëveshjes.

Opozita e vlerëson të dëmshme marrëveshjen e Uashingtonit

Dy subjektet opozitare kanë kritikuar qeverinë për marrëveshjen e 4 shtatorit. Madje Lëvizja Vetëvendosje ka paralajmëruar se nëse vjen në pushtet nuk do ta zbatojë këtë marrëveshje. Deputeti i kësaj lëvizje, Hekuran Murati, të enjten ka thënë se kjo marrëveshje i ka sjell shumë dëme Kosovës. “Pikërisht personi që ka shkruar e ka deklaruar në lidhje me dëmet e kësaj zone të ‘Mini-Schengenit’ përfundoi duke e nënshkruar këtë dhe arsytimi ishte që po e shkruajmë se po e kërkojnë miqtë tanë. Nëse Kosova ka shkruar për të bërë favore dhe monedhë kusuri për palë të treta, kjo nuk i kontribuon zgjidhjes së situatës”, ka deklaruar ai në një konferencë për media. Sipas tij, problemet mes dy shteteve janë politike e jo ekonomike. “Problemin me Serbinë nuk e kemi pasur asnjëherë ekonomik, s’ka qenë fare tregtia, sidomos te Serbia. Si e tillë, ajo na sjellë në këtë situatë ku nënshkruhet zotimi se Kosova do të bëhet pjesë e kësaj zone. Zakonisht emrat këto zona i marrin nga vendet ku bëhen. Pasi është nisur në Novi Sad, kjo qeveri ka nënshkruar që të bëhet pjesë e ‘Zonës së Novi Sadit’. Aty s’ka përfitime, por vetëm humbje”, ka thënë Murati. Kurse PDK-ja e ka kritikuar delegacionin e Kosovës, duke thënë se ka humbur shansin që në marrëveshjen e Uashingtonit të ndodhte edhe njohja e ndërsjellë në mes të Kosovës dhe Serbisë. “Çdo marrëveshje e nënshkruar në këtë mënyrë, pa transparencë, që nuk ka njohje të ndërsjellë,

krijon shqetësim dhe pasiguri. Aq më tepër, deri në këtë çast, nuk është bërë publike përmbajtja e marrëveshjes. PDK-ja që nga fillimi ka qenë e bindur se përfshirja e ShBA-së në procesin e përfundimit të dialogut në mes të Kosovës e Serbisë është e domosdoshme, por marrëveshjet që nuk parashohin njohje të ndërsjellë nuk ofrojnë zgjidhje të problemit në mes të Kosovës dhe Serbisë.” Ka vlerësuar PDK-ja. Më 4 shtator kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, në prani të presidentit të Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, kanë nënshkruar marrëveshje për normalizim

ekonomik. Me këtë marrëveshje palët janë zotuar se do të zbatojnë një sërë marrëveshjesh të arritura tashmë, siç është ajo për autostradën në mes të Kosovës dhe Serbisë, ajo për hekurudhat dhe për linjën ajrore. Po aty parashihet që Kosova dhe Serbia t’i përshpejtojnë përpjekjet për t’i lokalizuar dhe identifikuar mbetjet e personave të humbur. Në bazë të marrëveshjes, Kosova dhe Serbia do t’i bashkohen “zonës së mini-Schengenit”, që është krijuar më 2019 dhe ku tashmë marrin pjesë Serbia, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut.

Kosova, sipas marrëveshjes, është pajtuar që brenda një viti të mos kërkojë anëtarësim në

organizata ndërkombëtare. Serbia, në anën tjetër, është pajtuar që brenda një viti ta ndalë fushatën për çnjohjen e pavarësisë së Kosovës. Sa i përket Liqenit të Ujmanit, në marrëveshje thuhet se palët do të punojnë me Departamentin Amerikan të Energjisë për një studim fizibiliteti, me qëllim të përdorimit të përbashkët të këtij liqeni si furnizues i sigurt i ujit dhe energjisë.

Në bazë të dokumenteve të nënshkruara, Serbia ka rënë dakord për zhvendosjen e ambasadës nga Tel Avivi në Jerusalem dhe Kosova të vendosë marrëdhënie diplomatike me këtë shtet. Autoritetet e Kosovës kanë thënë se, po ashtu, do ta hapin ambasadën në Jerusalem.

Aprovimi i kredive nga bankat e Kosovës arrin nivele rekorde që nga paslufta

PRISHTINË, 10 SHTATOR (ER) - Në bazë të të dhënave të raportuara për periudhën e fundit të muajit korrik 2020, niveli i kredive të reja të aprovuara vetëm për këtë muaj ka shënuar vlerën prej 181.5 milionë eurosh, vlerën më të lartë që prej krijimit të sistemit bankar në Kosovë.

Kryeshefi ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës, Petrit Balija, ka thënë se kjo vlerë rekorde e arritur e sektorit bankar është shënuar, megjithëse gjashtëmujori i parë i vitit 2020 ka rezultuar të jetë me sfida të mëdha nga goditja e rëndë e

pandemisë globale Covid-19, duke rezultuar në pasoja të mëdha si për shëndetin e njerëzve, po ashtu edhe për sektorë të ndryshëm të ekonomisë. “Qëllimi i sektorit bankar është që të vazhdojë ta kreditojë ekonominë e Kosovës duke u mundësuar bizneseve dhe ekonomive familjare që të kenë qasje në financa në këto rrethana kur kërkohet më shumë likuiditet për ekonominë e Kosovës”, ka shtuar Balija.

Të dhënat e fundit tregojnë që krahas kreditimit të lartë, bankat kanë aprovuar një numër të konsiderueshëm të aplikacioneve

për shtyrjen e pagesave të kredive në vlerë prej 1.5 miliard eurosh, duke krijuar fleksibilitetin e nevojshëm në ekonomi gjatë kësaj periudhe.

Norma mesatare efektive e interesit për kredi ka shënuar rritje të dukshme në vitet e fundit duke arritur në 6.2 për qind, normë kjo që është në mesataren e rajonit. Shoqata e Bankave të Kosovës mirëpret aprovimin e draftligjit për rimëkëmbje ekonomike dhe apelon te Kuvendi i Republikës së Kosovës që sa më shpejt të miratojë këtë ligj dhe të zbatohet për ta shpëtuar ekonominë e Kosovës.



për të gjitha komunitetet joshumicë”, ka theksuar Stano. Sipas zëdhënësit të BE-së, ky është qëndrimi i përbashkët i të gjitha vendeve anëtare të BE-së. “Është koha e fundit që të gjendet një zgjidhje e pranueshme për të dyja anët. Kjo është dashur të ndodhë qëmoti. Po punojmë që këto probleme t’i sjellim deri te një zgjidhje reale”, ka porositur Stano.

Në vijë me ShBA-në dhe BE-në, edhe qeveria argumenton se marrëveshja e Uashingtonit dhe dialogu me Serbinë është në interes të Kosovës. Teksa e ka informuar kabinetin qeveritar për marrëveshjen e Uashingtonit dhe procesin e dialogut, kryeministri Avdullah Hoti ka deklaruar se ky proces po e fuqizon sovranitetin e Republikës së Kosovës. “Marrëveshja e arritur në Uashington është hap tepër i madh, hap i jashtëzakonshëm drejt marrëveshjes finale për normalizim të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë, që nënkupton njohje reciproke në mes të dy vendeve”, ka deklaruar Hoti.

Ai ka treguar se shtylla kryesore

Malisheva, e qetë dhe stabile në fushën e sigurisë

MALISHEVË, 10 SHTATOR (ER) - Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS) në Malishevë, nën drejtimin e kryetarit të komunës, Ragip Begaj, ka mbajtur mbledhjen e rregullt të saj, ku është vlerësuar situata e sigurisë në Komunën e Malishevës, situata me pandeminë dhe përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor. Situata e sigurisë në Komunën e Malishevës u vlerësua e qetë, stabile dhe pa tendencë të prishjes së kësaj situatë, pavarësisht prej rrethanave aktuale, sidomos me pandeminë Covid-19. Sipas komandantit të stacioni policor në Malishevë, kapiten Azem Krasniqi, situata është e qetë, nuk ka rrezik të prishjes së

situatës së sigurisë, pavarësisht prej rrethanave, e sidomos situatës pandemike, e cila ka mundur të ndikojë në rritjen e rasteve të veprave penale për shkak të efektit të mbylljes apo karantinimit për një kohë të gjatë. Po ashtu edhe aksidentet në trafik kanë shënuar rënie, e për këtë ka ndikuar edhe situata me pandemi, pasi janë reduktuar lëvizjet. Ndërsa për situatën aktuale pandemike foli kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, i cili i njoftoi anëtarët e KKS-së me situatën aktuale, për menaxhimin e situatës nga ana e shtabit komunal, si dhe për ofrimin e shërbimeve të nevojshme shëndetësore dhe shërbimet e tjera për të gjitha

rastet e prekura. Begaj tha se numri i vdekjeve është i madh në krahasim me numrin e banorëve dhe numrin e të prekurve dhe kjo, sipas tij, është shqetësuese. Për menaxhimin e situatës pandemike, kryetari Begaj i ka falënderuar të gjithë ata që janë të angazhuar direkt apo indirekt, duke filluar nga stafi shëndetësor, policia, shtabi komunal dhe të gjithë të tjerët që kanë kontribuar për menaxhimin e situatës, e cila, sipas anëtarëve të KKS-së dhe sipas përgjegjësve, u vlerësua e menaxhueshme dhe nën kontroll të plotë. Për përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor, drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, Blerim



Thaçi, tha se janë bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor dhe në këtë drejtim, sipas tij, Komuna e Malishevës e ka një përparësi për zbatimin e masave anti covid, sepse ka hapësirë të mjaftueshme në

objektet shkollore, përjashtuar gjimnazin ku numri i nxënësve është shumë i madh dhe mësimi do të zhvillohet i kombinuar, apo sipas planit B, ndërsa në shkollën fillore në Malishevë mësimi do të mbahet në tri ndërrime.

Kryetari i Hanit të Elezit kërkon përkrahje nga Ministra e Shëndetësisë



HANI I ELEZIT, 10 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, Rufki Suma, ka pritur të enjten në takim pune ministrin e Shëndetësisë, Armend Zemaj. Në këtë takim temë kryesore e bisedimit ishte gjendja e pandemisë Covid-19 si dhe vlerësimi i kapaciteteve të komunës për ta menaxhuar këtë situatë. Në këtë drejtim kryetari Suma e informoi ministrin Zemaj për gjendjen aktuale sa i përket situatës me Covid-

19, duke theksuar se Komuna e Hanit të Elezit deri më tani ka pasur gjithsej 30 raste, prej të cilëve aktualisht tetë raste aktive. Për kryetarin Suma, pavarësisht prej vështirësive fillestare, gjendja është menaxhuar mirë, furnizimi me pajisje mbrojtëse, dezinfektues dhe mjete të tjera të domosdoshme ka qenë e mirë. Kryetari i komunës, Rufki Suma, e njoftoi ministrin Zemaj edhe me sfidat me të

cilat po ballafaqohet sektori i shëndetësisë në Komunën e Hanit të Elezit dhe nga ai kërkoi përkrahje nga Ministria e Shëndetësisë. Ndërsa ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, pasi e njoftoi kryetarin Suma për aktivitetet e ministrisë të cilin ai e drejton, theksoi se vetëm falë një bashkëpunimi të mirë ndër-institucional do të arrihet të tejkalohet edhe kjo sfidë e rëndë e shëndetësisë.

Haziri: Rinia e Gjilanit dhe Kosovës po dëshmojnë në të gjithë botën me punë dhe kulturë

GJILAN, 10 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka ndarë mirënjohje për bashkatdhetaren Saranda Matoshi për kontributin dhënë në komunitet dhe arritjet që ka shënuar në fushën e teknologjisë. Haziri ka thënë se Saranda dikur ishte punëtore në administratën e Komunës së Gjilanit, e cila me angazhimin e saj dhe përkushtimin ndaj arsimimit, veçanërisht fushës së teknologjisë, sot është analiste ditore e databazës së të dhënave në kompaninë gjigante, në Microsoft, në Shtetet e

Bashkuara të Amerikës. Ai ka potencuar se rinia e Gjilanit dhe Kosovës është një thesar i vërtetë që e kanë dëshmuar veten në të gjitha fushat, me punë, arsim dhe kulturë të lartë njerëzore, kudo që kanë jetuar dhe për këtë ka vlerësuar se janë krenaria e Gjilanit. Ndërsa në fjalën e saj, pas pranimin të mirënjohjes, Saranda Matoshi, ka falënderuar Komunën e Gjilanit e cila është mbështetëse e rinisë kudo që ata jetojnë dhe i vlerëson e mirëpret gjithmonë kur kthehen në vendlindjen e tyre.



Gjakova vazhdon reformat në fushën e menaxhimit të mbeturinave

GJAKOVË, 10 SHTATOR (ER) - Komuna e Gjakovës vazhdon reformat në fushën e menaxhimit të mbeturinave si përfituese e projektit "Shërbime të Qëndrueshme Komunale" (SMS) të GIZ në Kosovë. Komuna e Gjakovës, përkatësisht Drejtoria e Shërbimeve Publike me Sektorin e menaxhimit të mbeturinave, në bashkëpunim me Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH dhe organizatën joqeveritare në

Kosovë Green Art Center - Prishtina (GAC), në kuadër të projektit "Pilotimi i Kompostimit në Shtëpi në 6 Komuna të Kosovës", janë duke bërë të gjitha përgatitjet rreth planit të veprimit për nisjen e ndarjes së mbeturinave organike në amvisëri. Ky projekt është planifikuar të shtrihet në disa lagje dhe fshatra ku, sipas planeve të komunës, parashihet që në fazën e parë të projektit të pilotimit të kompostimit shtëpiak


të përfshijë 306 amvisëri të cilat do të pajisen me komposterë shtëpiakë 280l për ndarjen e mbeturinave organike, në zonën qendër të qytetit, Lagja e "Bllokut të Ri" dhe Lagja e "Cabratit" dhe një pjesë të fshatrave Dol, Pjetërshan dhe Dobrigje, me tipologji të banimit individual dhe që kanë kapacitet të prodhimit të mbeturinave organike dhe ato të oborreve, për të tentuar në fazën e radhës me zgjerimin e pilotimit të kompostimit shtëpiak.



Vazhdon trendi i rënies së rasteve të reja me Covid në Kosovë

Shtatë të vdekur, 107 të shëruar dhe 69 raste të reja me Covid

Gjatë 24 orëve të fundit në Kosovë shtatë persona e kanë humbur betejën me Covid. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se gjatë kësaj periudhe kohore janë shëruar 107 persona dhe janë paraqitur 69 raste të reja me koronavirus. “Numri total i rasteve pozitive është 14 446 raste nga 56 045 persona të dyshimtë me virusin SARS-CoV-2 dhe 581 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 107 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 11 033 raste, kurse numri i rasteve aktive është 2 832”, ka njoftuar IKShPK-ja



Mitrovicë 5 raste, komuna Deçan 4 raste, komuna Malishevë 4 raste, komuna Drenas 3 raste, komuna Gjilan 3 raste, komuna Pejë 3 raste, komuna Suharekë 3 raste, komuna Ferizaj 2 raste, komuna Gjakovë 2 raste, komuna Kamenicë 2 raste, komuna Kaçanik 2 raste, komuna Rahovec 2 raste, komuna Viti 2 raste dhe me nga një rast komunat Graçanicë,

Istog, Obiliq, Podujevë, Prizren, Shtime dhe Vushtri”, ka njoftuar IKShPK-ja.

“Soros”-i ndan 1.5 milion euro donacion për IKShPK-në për blerje të testeve për Covid

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka bërë me dije se fondacioni “Soros” ka ndarë

1.5 milion euro donacion për blerjen e testeve PCR për nevojat e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK). Zemaj ka thënë se ky donacion është një kontribut i vlefshëm për rritjen e fuqisë diagnostikuese për Covid-19. “Në takimin e sotëm me z. Luan Shllaku, drejtor ekzekutiv i Fondacionit për Shoqëri të Hapur (KFOS), u informova se fondacioni ‘Soros’ ka ndarë 1.5 milion euro donacion për të blerë teste PCR për nevoja të institucioneve publike shëndetësore në Kosovë. Ky do të jetë një kontribut i vlefshëm në rritjen e fuqisë testuese për diagnostikimin e infeksionit Covid-19 në Kosovë dhe për krijimin e mundësive më të mëdha për rritjen e testeve molekulare”, ka thënë Zemaj.

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se gjatë 24 orëve të fundit kanë vdekur shtatë persona si pasojë e infeksionit me Covid-19. Po ky institut ka bërë me dije se gjatë kësaj periudhe kohore janë shëruar 107 persona dhe janë paraqitur 69 raste të reja. “Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 532 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 69 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar 7 raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv. Numri total i rasteve pozitive është 14 446 raste nga 56 045 persona të dyshimtë me virusin SARS-CoV-2 dhe 581 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 107 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 11 033 raste, kurse numri i rasteve

aktive është 2 832”, ka njoftuar IKShPK-ja, duke treguar për numrin e rasteve të reja me Covid sipas komunave. “Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 22 raste, komuna



Qeveria e Kosovës dhe ajo e Maqedonisë në ditët e ardhshme mund të vendosin për lehtësimin e kalimeve kufitare



SHKUP, 10 SHTATOR (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka vizituar të enjten Maqedoninë e Veriut, ku është pritur në takim nga homologu i tij maqedonas, Venko Filipçe, me të cilin ka biseduar në lidhje me pandeminë Covid-19 dhe me lehtësimin e kalimeve kufitare në mes të dy shteteve. “Bashkëpunimi rajonal është shumë i rëndësishëm, në veçanti tash për menaxhimin e pandemisë Covid-19. Sot gjatë vizitës zyrtare në Maqedoninë e Veriut, në takimin me homologun Venko Filipçe, diskutuam për këtë

temë dhe çështje të tjera. Jemi pajtuar për grupe të përbashkëta pune, për thellimin e bashkëpunimit si për fushën e specializimeve dhe subspecializimeve dhe për trajnimet e profesionistëve shëndetësorë të dy shteteve. Gjithashtu, biseduam edhe për vlerësimet dhe vendimet e përbashkëta rreth lehtësimit të kalimeve kufitare për çka dy qeveritë mund të vendosin në ditët në vijim”, ka thënë Zemaj. Me këtë rast, Zemaj, ka falënderuar ambasadorin e

Kosovës në Maqedoninë e Veriut, Gjergj Dedaj, për përkushtimin e tij për avancimin e raporteve Kosovë - Maqedoni e Veriut. “Bashkëpunim dhe solidaritet kundër Covid-19! Bashkëpunimi rajonal është shumë i rëndësishëm, në veçanti tash për menaxhimin e pandemisë Covid-19. Jemi pajtuar për grupe të përbashkëta pune, për thellimin e bashkëpunimit si në fushën e specializimeve, por edhe të subspecializimeve dhe trajnimet e profesionistëve shëndetësorë të dy shteteve”, ka thënë Zemaj.

Oda Amerikane prezanton programin BERZh për përmirësim të menaxhimit financiar

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Menaxhimi më i mirë i financave të ndërmarrjeve si dhe raportimi korrekt i tyre ka marrë një rëndësi të theksuar sidomos gjatë periudhës së pandemisë Covid-19, e cila ka shkaktuar çrregullime të paprecedentë mbi ekonominë e vendit. Kjo u tha gjatë një forumi virtual të organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, në bashkëpunim me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Ernst and Young Kosovo and Albania (EY), gjatë së cilës u prezantua Programi i BERZh-it për Përmirësimin e Menaxhimit Financiar dhe mundësitë që ofron Ernst and Young për mbështetje të këtij programi.


Arian Asolli, analist në

programin e BERZh-it Këshilla për Bizneset, ka theksuar qëllimet e këtij programi të cilat, mes të tjerash, përfshijnë përmirësimin e kapaciteteve të kompanive vendore për menaxhim dhe raportim financiar, në mënyrë që të njëjtat të krijojnë lehtësira për qasje direkte apo indirekte në kreditë që ofron BERZh-i, si dhe rritjen e atraktivitetit të bizneseve për investitorët vendës dhe ata të huaj.

Asolli, po ashtu, ka shtjelluar kriteret të cilat duhen plotësuar nga bizneset për përfshirje në këtë program, kurse ka përmendur edhe profilin ideal të kompanive që kjo bankë po kërkon.

Ai, gjithashtu, bëri me dije se përkrahja e BERZh-it do të jetë 75 për qind e kostove totale.

Emel Visha, menaxhere në zyrën e EY Kosovo and Albania për Strategji dhe Transaksione,



theksoi se në kuadër të këtij programi, EY nëpërmjet strukturave të veta ka krijuar modelin e qëndrueshmërisë së ndërmarrjeve, të ndarë në tri etapa, të cilat përfshijnë përgjigjen me urgjencë tani, përgatitjen për të ardhmen dhe të menduarit tutje, duke marrë në konsideratë çrregullimet e shkaktuara nga pandemia Covid-19. Ajo ka potencuar

pikat kryesore për ndërhyrje në biznes ku kjo kompani mund të ofrojë asistencë, duke përmendur përgatitjen e një plani të biznesit, parashikimin e likuiditetit dhe analizën e skenarëve, si dhe përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për proceset e aplikimit për ndihmë financiare.

Për më tepër, Visha foli edhe për problematikat e ndryshme të

cilat po i hasin bizneset dhe mbështetjen që EY mund të ofrojë për adresimin e të njëjtave.

Shkëmb Gashi, menaxher në Departamentin e Auditimit në kompaninë "Ernst and Young Kosovo and Albania", foli për gjendjen aktuale të ekonomisë së Kosovës, duke tërhequr paralele në mes të situatës para-pandemike dhe asaj të tanishme, duke vlerësuar ndikimet që pandemia Covid-19 ka pasur mbi veprimtarinë e bizneseve dhe ekonominë në përgjithësi. Ai theksoi një ndër problematikat më primare me të cilat ballafaqohen ndërmarrësit sot, siç është risku i vijimësisë së biznesit, duke shtuar se EY ofron mbështetje përmes analizave të ndryshme makroekonomike, të faktorëve specifikë të ndërmarrjes që mund të ndikohen nga pandemia dhe analiza të tjera sipas nevojës.

OAK-u kërkon nga ATK-ja lehtësim dhe mirëkuptim për bizneset në kohë pandemie

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Gjendja e krijuar në vend si pasojë e pandemisë Covid-19 ka rënduar shumë sektorin privat të vendit. Kësaj, shumë biznese po detyrohen ta shkurtojnë numrin e punëtorëve brenda kompanive, për të cilët punëdhënësit kanë investuar në trajnimin e tyre për t'i aftësuar për atë vend pune.

Nga ana tjetër, punëdhënësit nuk mund t'i mbajnë ata punëtorë në kompani më gjatë për shkak se nuk janë në gjendje të paguajnë për shërbimet e tyre. Për t'u treguar tolerant dhe për t'i ndihmuar sadopak këto biznese për kalimin e kësaj



gjendje të vështirë me të cilën po ballafaqohemi, të enjten u diskutua në tryezën e Administratës Tatimore të Kosovës me Odën e Afarizmit të Kosovës.

Kryetari i OAK-së, Skender

Krasniqi, ka kërkuar nga drejtori i përgjithshëm i ATK-së, Ilir Murtezaj, mirëkuptim për bizneset e rregullta.

Ndërsa Murtezaj ka theksuar se kanë mbetur në mes të ligjit dhe moralit, e që po rrezikojnë

prishjen e sistemit tatimor.

OAK-u, gjithashtu, ka kërkuar që të mos bëhet mbyllja e kontove dhe kësaj të mos vijë edhe deri te mbyllja e bizneseve, pavarësisht mospagimit të borxheve tatimore gjatë këtyre

muajve të fundit pasi që të gjitha bizneset aktualisht janë duke u ballafaquar me vështirësi të shumta financiare.

Po ashtu, kërkesë tjetër e OAK-së ishte edhe rritja e numrit të inspektorëve të Administratës Tatimore të Kosovës dhe atyre komunalë me qëllim që të gjitha bizneset të jenë të barabarta dhe të punojnë në bazë të ligjit të punës i cili është në fuqi.

Nga zyrtarët e ATK-së është bërë me dije se nga marsi deri në korrik të 2020-s ka një rënie prej 20 përqindësh apo rreth 900 milionë euro më pak qarkullim të bizneseve në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2019.

Krasniqi zotohet për përkrahje të përpunuesve të qumështit

PRISHTINË, 10 SHTATOR (ER) - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Vesel Krasniqi, ka pritur në një takim zëvendësministrin e Bujqësisë, Nehat Ramadani, drejtuesit e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës, si dhe përfaqësuesit e Shoqatës së Përpunuesve të Qumështit dhe përfaqësuesit e prodhuesve të qumështit. Në këtë takim është diskutuar për problemet me të cilat po përballen prodhuesit dhe përpunuesit e qumështit si pasojë e pandemisë. Po ashtu, është kërkuar që Qeveria e Kosovës t'u bëjë një zgjidhje për shkak të sasisë së grumbulluar të djathit, të ndalohet vaji i palmës, të ndalen

produktet e qumështit bimore dhe shtazore etj.

Ministri Krasniqi ka shprehur gatishmërinë e tij që t'i përkrahë kërkesat e tyre dhe t'u bëhet një zgjidhje sa më e shpejtë. Ai ka kërkuar që t'i sjellin të dhënat e sakta se sa janë stoqet e djathit dhe sa është kapaciteti i prodhuesve vendorë për ta mbuluar kërkesën e tregut në mënyrë që të shqyrtohet mundësia e një vendimi që do t'u bëhet një zgjidhje prodhuesve vendorë. "Jam shumë i interesuar dhe po angazhohem që t'u dal në ndihmë duke ofruar zgjidhje me vendime institucionale, që prodhuesit vendorë ta ndiejnë

dorën e shtetit. Por duhet thënë se çdo vendim që merret duhet të ketë një arsyeshmëri, një bazë ligjore që vendimi i ministrit të jetë i qëndrueshëm. Prandaj kërkoj nga ju që t'i sillni të dhënat e sakta se sa janë stoqet, sa është konsumi dhe sa është prodhimi ditor? Nëse nuk kemi të dhëna për kapacitetet tona prodhuese, ne nuk mund të marrim vendime, që pastaj mund të na nxjerrin telashe të tjera", ka deklaruar ai.

Sa i përket kërkesës që t'u bëhet një zgjidhje për stoqet, Krasniqi është zotuar se do t'u bëjë një kërkesë të gjitha institucioneve publike që të furnizohen me



produkte vendore të qumështit, si një ndihmë shtesë për prodhuesit vendorë.

I një qëndrimi me ministrin ishte edhe zëvendësministrin i BPZHR-së, Nehat Ramadani, duke

kërkuar të dhëna të sakta nga përfaqësuesit e shoqatave të pranishme. Ndërsa drejtuesit e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës kanë folur kryesisht për cilësinë e produkteve.

Departamenti Amerikan i Shtetit vlerëson lart sektorin financiar në Kosovë



Departamenti Amerikan i Shtetit ka publikuar raportin për klimën e investimeve për vitin 2020 për Kosovën, në të cilin është dhënë vlerësim i lartë për sistemin financiar të vendit. Ky raport thekson se sistemi rregullator përputhet me direktivat e BE-së dhe me standardet ndërkombëtare, nuk ka kufizime përtej kërkesave normale rregullatore në lidhje me burimin e kapitalit, përshtatshmërinë dhe aftësinë e investitorëve dhe se BQK-ja ka marrë të gjitha masat e kërkuara për t'i përmirësuar politikat për rrjedhën e lirë të burimeve financiare

EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Departamenti Amerikan i Shtetit ka publikuar raportin për klimën e investimeve për vitin 2020 për Kosovën, ku është dhënë vlerësim i lartë për sistemin financiar të vendit. Raporti thekson faktin se Kosova ka një ekonomi të tregut të hapur dhe tregu përcakton normat e interesit.

Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit thekson se sistemi rregullator përputhet

me direktivat e BE-së dhe standardet ndërkombëtare, nuk ka kufizime përtej kërkesave normale rregullatore në lidhje me burimin e kapitalit, përshtatshmërinë dhe aftësinë e investitorëve dhe se BQK-ja ka marrë të gjitha masat e kërkuara për t'i përmirësuar politikat për rrjedhën e lirë të burimeve financiare. "Në raport është theksuar edhe qëndrueshmëria e sektorit bankar, i cili mbetet mirë i kapitalizuar dhe fitimprurës. Kushtet e vështira ekonomike, zbatimi i dobët i kontratës dhe

sjellja e paqartë ndaj rreziqeve kanë kufizuar aktivitetet e huazimit të bankave, megjithëse përmirësimi i dukshëm ndodhi në vitet e fundit. Në shkurt të vitit 2020 norma e kredive joperformuese ishte 2.5 për qind, niveli më i ulët në dhjetë vjetët e fundit. Normat e interesit kanë rënë ndjeshëm në vitet e fundit, nga një mesatare prej 12.7 përqindësh në 2012-n, në një mesatare prej 6.3-përqindësh në vitin 2020. Kreditimi më i ngadaltë është i dukshëm në pjesën veriore të Kosovës për

shkak të një gjyqësori të dobët, aktiviteteve informale të biznesit dhe më pak të kualifikuar huamarrësit", është bërë me dije në komunikatën e BQK-së.

Në këtë komunikatë është theksuar se BQK-ja është përgjegjëse për nxitjen e zhvillimit të praktikave konkurruese, të shëndosha dhe transparente në sektorin bankar dhe financiar. "BQK-ja mbikëqyrë dhe rregullon sektorin bankar të Kosovës, industrinë e sigurimeve, fondet e pensionit dhe institucionet mikrofinanciare. BQK-ja, gjithashtu, kryen detyra të tjera standarde të bankës qendrore, duke përfshirë administrimin e parave të gatshme, transferimet, pastrimin, menaxhimin e fondeve të depozituara nga Ministria e Financave dhe institucione të tjera publike, mbledhjen e të dhënave financiare dhe menaxhimin e Regjistrimit të Kredive", thuhet në këtë komunikatë të BQK-së.

Raporti thekson se bankat dhe

degët e huaja mund të kryejnë operacione në vend, duke iu nënshtruar të njëjtave kërkesa dhe rregulloreve të licencimit si bankat vendëse. "Vendi nuk ka humbur asnjë marrëdhënie bankare korrespondente në tri vjetët e fundit dhe asnjë marrëdhënie e tillë aktualisht nuk është në rrezik. Nuk ka kufizime në hapjen e llogarive bankare nga të huajt. Ata mund ta bëjnë këtë me dorëzimin e dokumentacionit të vlefshëm të identifikimit. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës shpreh vlerësimin më të lartë për raportin që ka të bëjë me pjesën e sektorit financiar dhe shpreh falënderimin më të sinqertë për Departamentin Amerikan të Shtetit për vlerësimin real të sektorit financiar në Kosovë dhe Ambasadën Amerikane në Kosovë, për përkrahjen e vazhdueshme që i ka dhënë që nga fillimi dhe vazhdon t'i japë BQK-së në zhvillimin e mëtejshëm të këtij sektori", është theksuar në komunikatën e BQK-së.

Diskutohet për pagesën prej 300-eurosh për punëtorët teknikë

PRISHTINË, 10 SHTATOR (ER) - Kryetari i Sindikatës së Pavarur i Sektorit Privat të Kosovës, Jusuf

Azemi, ka takuar të enjten zëvendëskryeministrin Driton Selmanaj. Temë e takimit ishte

futja në listën e stimulimit me pagesën prej 300 eurosh për punëtorët teknikë që punojnë

në qendrën spitalore dhe qendrat e mjekësisë familjare dhe ambulancave.





Marrëveshja Kosovë - Serbi në Uashington

Një port shqiptar do të bëhet dalje e shtetit serb në Adriatik. A ka rënë dakord Qeveria e Tiranës?



Nga Bedri ISLAMI

Më 4 shtator, në praninë e presidentit amerikan, dy shefat e delegacioneve, i Qeverisë së Kosovës, Avdullah Hoti dhe Vuçiqi i presidencës serbe, nënshkruan një akt për normalizimin e marrëdhënieve ekonomike. Të gjitha pikat e renditura në aktin final, pasi ai ndryshoi deri në momentin e fundit, fillimisht nga pala serbe që nuk prante njohjen reciproke dhe pastaj nga pala shqiptare që kontestonte çështjet që lidhen me liqenin e Ujmanit, nuk kanë të bëjnë në pamjen e parë të tyre me qëndrime politike apo të njohjes së ndërsjellë, megjithëse pas kulisave palët janë pajtuar se po shkohet drejt një gjendjeje të re dhe, si opozitarët e mbështetësit e presidentit serb, ashtu edhe mediat ruse, e vërejtën se diçka ka lëvizur në këtë bosht që, edhe ashtu si është paraqitur, megjithëse nuk është një hap i madh përpara, nuk është një kthim pas.

Ka disa momente që të bëjnë të shikosh me dëshirë aktmarrëveshjen, ashtu si disa të tjera që të lënë shijen e hidhur dhe mund të kenë pasoja afatgjata në

tërë zhvillimin dypalësh e shumëplanësh në këtë pjesë të Ballkanit, ku mëria është edhe më e fuqishme sa marrëveshja dhe ku viktimat kanë qenë disa herë më të larta se sa mund të ishte menduar. Në katër vitet e administratës Trump marrëdhëniet mes politikës në Kosovës dhe të ShBA kanë qenë herë-herë të ngarkuara dhe, nëse përplasjet nuk janë shfaqur krejt haptas, kushdo e ka ditur se gjërat po shkojnë drejt keqësimit. Sa ishte kjo në interesin e Kosovës dhe të perspektivës së saj? - kjo tashmë dihet. Përplasjet me Qeverinë Haradinaj për taksën 100 për qind e, më tej, me qeverinë Kurti, ku gjërat u ashpërsuan rrënjësisht janë të njohura, ashtu si edhe kundërveprimi evropian i strukturave të vendosura në passkenë, për të paraqitur nën një dritë politike çështje që lidhen me Gjykatën Speciale, e cila, sipas dëshmiave të fundit, më shumë se gjysmën e materialeve të saj e ka marrë nga hetuesit e prokurorët serbë, e jo vetëm për kohën kur ua lejon mandati, por në të gjithë kohën, e, për më tej, duke i cilësuar njëjtë si regjimi i Millosheviqit, luftëtarët e UÇK-së si terroristë. Përfshirja e presidentit amerikan në bisedime, gjithnjë sipas stilit të tij çoroditës, është shenjë vlerësimi, edhe pse ai kalkulon të ardhmen e tij politike.

Sado që njerëzit e politikës serbe të shkojnë me kostume të kohëve të fundit, ata ende kanë mbi vete e me vete qyrkun e mentalitetit sllavomadh dhe ultranacionalist,

të cilin nuk ua hoqi dot as presidenti amerikan, megjithëse i vendosi në rresht si nxënës fillestarë, çka e bëri më pas edhe me shefin e qeverisë së Kosovës. Përparësia e parë ishte se në të gjithë këto muaj, jo vetëm në media që janë opozitare ndaj qeverisë së Tiranës - por edhe në njerëz të politikës në Kosovë, është synuar që gjithçka të paraqesë një tablo tjetër, ku në zyrën ovale, përkulur mbi harta dhe me thikë në duar, po ndahet ashpërsisht Kosova, duke i ngulur asaj një hanxhar pas shpine. Ndërthurësit e kësaj megaideje politike nuk e kishin për gjë të duartrokisnin fitoren e një partie thellësisht pro serbe dhe pro ruse në Malin e Zi, ultranacionaliste, e lidhur ngushtë me Kishin Ordhodokse serbe, e cila në fakt ishte fituese e zgjedhjeve dhe ku falën puthadorë gjithë fituesit, e cila nuk e njeh shtetin e Kosovës dhe është thellësisht kundër zhvillimeve në Shqipëri e në Kosovë.

Sado që administrata Trump e përdor për qëllimet e saj elektorale takimin dhe kjo është tepër e dallueshme, fakt është se edhe një brez tjetër politikanësh nuk e humbën lidhjen me Kosovën dhe dosja e saj është ende në Shtëpinë e Bardhë. Shqiptarët në Kosovë nuk u braktisën si kurdët luftëtarë kundër ISIS, e as nuk u trajtuan përçmueshëm, ndryshe nga sa mund të ishte trajtuar pala serbe. Moshumbja e lidhjeve, sado që i deleguari i zotit Trump është një figurë e pazakontë politike, por

asnjeri nuk mundet të detyrojë presidentin amerikan të caktojë kë duam ne - ishte e pranishme në të gjithë këtë agjendë, e cila mund të formulohet thjeshtë e dështuar nga shkaku i vendosjes së bashkëbiseduesve. Është e vërtetë se një përfaqësues shtetëror i Kosovës, apo i Serbisë nuk do të trajtohej kështu në zyrat e BE, por, po aq e vërtetë është se pikërisht zyrtarët e BE kanë kaq vite që e kanë mbyllur Kosovën si në një geto dhe, megjithë analizat e sakta të institucioneve evropiane të politikës dhe të sigurisë se, kjo mbyllje do të sjellë ashpërsim e mosbesim ndaj BE, përsëri, e përsëri, megjithë premtimet e bujshme, nuk lejohet lëvizja e lirë e qytetarëve të Kosovës në BE.

Ajo që ndodhi në Uashington është në fakt vazhdim i shumë proceseve të mëparshme. Nuk është arritja më e madhe e dekadave dhe as e këtyre viteve, por është dëshmi se ka ende interes dhe, nëse ende diplomacia ndërkombëtare vë kushte dhe ngushton rrethin, kjo, më shumë se me vetëdijen e tyre politike, ka të bëjë me vetëdijen tonë, që në vitet e paqes humbëm shumë nga ajo që u fitua në luftë. Asnjë qeveri serioze në botë nuk angazhohet thellësisht, deri në institucionin më të lartë të saj kur përballë vetes ka një amalgamë qeveritarësh, rrëzime qeverish dhe ndërtime qeverish me paterica, kur njerëzit e politikës janë të gatshëm të shpallin armik këdo që është kundër tyre dhe mik të shtrenjtë

pikërisht atë që kanë mallkuar dhe shantazhuar një ditë më parë.

Të paktën, njëri ndër njerëzit më të fuqishëm të botës, në mos më i fuqishmi aktualisht, bëri një lëvizje vazhduese, në mos për njohjen reciproke, çka administrata e tij e dëshironte, të paktën për stabilizimin e marrëdhënieve ekonomike.

Nëse qeveritarët shqiptarë të Kosovës në takim fluturuan me ambicien se pas tyre do të vijë njohja reciproke, është koha të ulen me këmbë në tokë dhe të mësojnë se jo gjithçka që thuhet, dhe ashtu si thuhet, do të bëhet.

E rëndësishme është që në këtë aktmarrëveshje nuk u vendos asnjë pikë që ka të bëjë me krijimin e legalizimin e mëtejshëm të Asociacionit të komunave me shumicë serbe. Kjo do të ishte vetëvraska e lirisë dhe e pavarësisë së Kosovës, pasi, menjëherë, sipas një politike të studiuar mirë e qartë dhe të rekomanduar nga grupi special i ngritur pranë qeverisë serbe, do të kishte zhvillime që do të çonin drejt bosnjëzimit të Kosovës, krijimit të enklavave serbe gjysmë të pavarura që do të synonin mëvetësi dhe lidhje të drejtpërdrejta me qeverinë e Beogradit.

Megjithëse qeveria beogradase dhe presidenti i këtij shteti ngulën këmbë që të kishte nene dhe pika të veçanta për ndërlikohen e tyre të drejtpërdrejta me komunat me shumicë serbe, edhe institucionalisht, çka e bëjnë ilegalisht, administrata amerikane

e hodhi poshtë atë, si të papajtuashme me marrëveshjen dhe kjo mund të sjellë risinë që parlamenti i Kosovës të demantojë këtë marrëveshje që në fillimet e saj.

Në Uashington, ndryshe nga sa ishte parashikuar dhe prononcuar me forcë, si nga opozita e atjeshme dhe burime mediale në Tiranë, nuk pati asnjë diskutim për ndarje të kufirit, shkëmbim terriroresh, lëvizje popullesie, ndarje të Kosovës; nuk u ngrit problemi i Trepçës dhe i ndarjes së Mitrovicës, për më tepër, koncerne të fuqishme amerikane janë të interesuara që të financojnë në Veriun e Kosovës, sipas bisedimeve paraprake me qeverinë e saj.

Askush nuk e ngriti shkëmbimin e territoreve dhe as ndarjen e Kosovës, e po ashtu, nuk u ngrit as kthimi i Kosovës Lindore, Luginën së Preshevës, në përbërjen e shtetit të Kosovës. E gjithë furia mediatiqe dhe politike, megjithëse ishte një gjetje e zgjuar politike, nuk ndjeu nocionin e ndarjes, sepse nuk kishte.

Natyrisht, për të gjithë, do të ishte mirë që të kishte një qëndrim thelbësor ndryshe të administratës së tashme amerikane, që mund ta sjellë nesër një administratë e mundshme Biden, më pro Kosovës, njohëse më e mirë e halleve dhe e qëndrimeve të saj, por kjo do të ndjehet pas nëntorit të këtij viti. Deri atëherë Kosova ka përbalë vetes, si në Shtëpinë e Bardhë, dhe pranë vetes, si në këto bisedime, këtë administratë dhe nuk e ka as luksin dhe as të vërtetën që ta shpallë armike, varrimshme të Kosovës dhe armike të saj. Ngutja në politikë është këshilltar i keq, po aq sa është dëgjimi i sirenavë që të ndjellin pushtetin, duke dashur krijimin e një mendësie ndryshe, trazuese, larg aspiratës dhe ndodhive historike.

Qeveria e Kosovës në nënshkrimin e aktmarrëveshjes, ashtu si ua sollën dhe pa njohje të thellë paraprake, ku gjithçka i ishte lënë në dorë negociatorit Skender Hyseni, la pas vetes shumë dilema dhe enigma, disa nga të cilat duhet të rrihen fort në parlamentin e Kosovës, por edhe në vetë institucionet qeverisëse.

Duke shkuar në Shtetet e Bashkuara me idenë se njohja reciproke ishte akt i kryer ata u lëshuan në nënshkrimin e disa marrëveshjeve, duke u gjendur para dilemës, "ose nënshkruani kështu si është, ose ikni pa e nënshkruar". Që kur janë krijuar bisedimet diplomatike gjithnjë palës më të dobët i bëhet presioni më i madh. Kjo ndodhi edhe me shqiptarët në bisedime, të cilët, një herë të vetme që kundërshtuan dhe krijuan rrezikun e rrëzimit të qeverisë përmes çështjes së liqenit të Ujmanit, fituan më shumë nga sa kishte parashikuar pala serbe. Përse ndodhi kështu, si edhe herë të tjera ka ndodhur?

Secili nga njerëzit e politikës në Kosovë mendon fillimisht për të ardhmen e tij e pastaj për të

nesërmen e Kosovës. Mjerisht, kështu është.

Ata, qeveritarët që menduan se do të hynin në histori, kthehen të dëshpëruar se iluzionin e agimit të një historie ndryshe e morën për të vërtetë dhe se rruga e tyre e gjatë dhe me aq shumë njerëz nuk dihej nëse ia kishte vlejtur, po të mos kishte qenë qëndrimi në zyrën ovale të Shtëpisë së Bardhë.

Loja luhej në ShBA, fijet tërhiqeshin në Prishtinë. Secili duke menduar se si mund të shfaqej më shpëtimtar dhe se kush do të ishte më atdhetar.

Njëra ndër çështjet që ka enigmën më të ndjeshme është krijimi i një porti në detin Adriatik, në ujëra të thella, i përbashkët për Kosovën dhe shtetin serb.

Ku mund të jetë ky port, veçse në Shqipëri. Prej kohe ekziston mendimi i shkëputjes nga porti i Selanikut dhe afrimi drejt një porti tjetër.

Nëse është në Shqipëri, atëherë është marrë edhe mendimi i palës shqiptare, i qeverisë së saj dhe i zotit Rama. Ndryshe nuk mund të vihej në një aktmarrëveshje ku shteti shqiptar nuk është nënshkruar.

Të gjitha qeveritë shqiptare i kanë joshur shqiptarët e Kosovës me idenë e portit të Shëngjinit, si porta hyrëse e mallrave në Kosovë. Të gjitha, veç e veç e së bashku, nuk kanë bërë thujtë asgjë. Për më tepër, rreth 60 për qind e mallrave në Kosovë janë prodhime serbe ose të dërguara nga firmat e mëdha serbe, që kanë lidhje të ndjeshme në Kosovë.

Mendimi i parë fillestar, edhe në kohën e qeverisë Berisha, ka qenë që porti të jetë për shqiptarët e Kosovës, pavarësisht se nuk u bë gjë. Edhe Edi Rama e qeveria e tij e kanë shfaqur këtë mendim dhe e kanë bërë këtë betim.

Tani jemi para një zgjidhjeje tjetër: do të jetë një port, cilido të jetë ai që, në një mënyrë a në një tjetër do të jetë edhe dalje e shtetit serb në Adriatik. Nëse qeveria shqiptare ka rënë dakord, atëherë duhet shtruar urgjentisht në të gjitha instancat e shtetit, që nga Këshilli i Sigurisë Kombëtare dhe deri në parlamentin e Shqipërisë.

Qeveria e Kosovës, edhe sot, po vendos në një plan të përbashkët tri pika, që u duken thelbësore: marrëveshjet ekonomike, të zhdukurit dhe të shpërngulurit.

Në pamjen e parë duken si çështje të barasvlershme, por nuk janë ashtu. Në marrëveshjet ekonomike pala që fiton më shumë, pra, pjesën e luanit, është ajo serbe, në territorin e së cilës do të ndërtohen autostrada të reja, rrugë hekurudhore, do të ketë investime të mëdha. Kosova është në bishtin e këtyre investimeve serioze. Ajo merr çka mbetet nga investimet në shtetin serb.

Të zhdukurit shqiptarë në luftën makabre, që ishte në fakt gjenocid, mbeten problemi më i madh për çdo qeveri në Kosovë. Cilado qoftë ajo. Është problemi i pazgjidhur dhe të cilin shteti serb nuk do ta zgjidhë kurrë. Sepse dëshmon

krimin e vjetër dhe të ri së bashku, mentalitetin e këtyre njerëzve që qeverisin, disa nga të cilët kanë qeverisur edhe në regjimin e Milloshviqit. Pa u zgjidhur thellësisht ky problem, nuk mund të bisedohet për çështje të tjera. Janë ende rreth 1 700 të zhdukur, familje të tëra kërkojnë fatin e të afërmeve të tyre dhe këtë asnjë qeveri nuk guxon ta harrojë.

Të shpërngulurit dihet në shumicë janë serbë të ikur gjatë e pas luftës, shumë nga të cilët kishin qenë pjesë e krimit të ndodhur në Kosovë. Ata, edhe pa një aktmarrëveshje, po kthehen dalëngadalë dhe për to po ndërtohen resorse të reja, të gjitha me financim të qeverisë serbe, nën hundën e qeverisë së Kosovës. Jo vetëm të së sotmes, por nën hundën e të gjitha qeverive. Qeveria serbe kërkon rikthimin masiv të tyre dhe nesër do të kërkojë edhe kthimin e pronave që kanë grabitur përmes vendimeve gjyqësore të kohëve të pushtimit serb.

Qeveria e tashme dhe qeveritë para saj ende nuk kanë asnjë forcë për të kthyer shqiptarët e shpërngulur me dhunë nga Mitrovica e Veriut, shtëpitë e të cilëve, ose janë të boshatisura, ose të zaptuara nga serbët paraushtarakë të bandave të njohura. Të shpërngulurit serbë, megjithëse disa prej tyre janë prej shumë kohe në Kosovë, kanë të drejtë të kthehen, por para tyre, doemos, shqiptarët e dëbuar në atë pjesë territori që është i Republikës së Kosovës.

Qeveria serbe as nuk kërkoi falje për krimet e bëra dy dekada më parë dhe as nuk ka ndërmend të diskutojë për dëmet e luftës. Ajo as çështjen e pagesave pensionale që kapin disa miliarda euro nuk e ka vënë në diskutim. Këto janë çështje që qeveria e Kosovës duhet t'i vërë para kujtdo, qoftë edhe njeriu numër një i botës, sepse kjo është rruga e zgjidhjes.

Po tani? Aktmarrëveshja ishte një iluzion më shumë, se sa një arritje, që mund të bëhet e vërtetë, nëse shteti serb nuk e saboton atë dhe nëse politika në Kosovë është rigorozë në kërkesat e saj.

Qeveria serbe gjithnjë ka sabotuar ato pika të marrëveshjeve ku ka pasur detyrime dhe ka ngritur zërin ku ka pasur të drejta. Kjo do të ndodhë edhe tani.

Ajo nga pesë të zhdukur në marsin e vitit 1999, ngriti numrin e tyre në 56 në qershorin e këtij viti, më pas në 100 dhe gjeti edhe bashkëmendimtarë në Tiranë e Prishtinë që shkruan për qindra të zhdukur. Nga inati i sime vjehrrë, vajta e fjeta me mullixhinë - është një fjalë e vjetër.

Edhe tani, pa asnjë dyshim, qeveria serbe do të gjejë çdo shkak për t'i pasur ankesat e saj dhe këto do të jenë pambarim.

Ndaj, për të gjitha qeveritë ka vetëm një rrugë: të ulet në bisedimet e mëpasshme vetëm pas njohjes reciproke, ndryshe zhvillimet mund të bëhen edhe pa qenë në një tryezë me njerëzit e politikës serbe.



Mbyllet çerdhja publike në Fushë-Kosovë, shkaktar Covidi

Fushë-Kosovë, 10 shtator (ER) - Komuna e Fushë-Kosovës ka njoftuar se është mbyllur për kohësisht çerdhja publike pasi disa punëtorë kanë rezultuar pozitivë me Covid-19.

"Njoftojmë prindërit që i kanë fëmijët e tyre në çerdhen publike në Fushë-Kosovë, se ky institucion do të mbyllet për kohësisht derisa të krijohet rrethana të reja të favorshme pune. Sot, pas testimit të stafit punonjës të IP 'Gëzimi Ynë', disa punëtorë kanë rezultuar pozitiv me Covid-19.

Zëvendësimi i këtyre punonjësve për momentin është i pamundur për shkak të procedurave. Për çdo njoftim apo vendim tjetër rreth kësaj çështjeje do të njoftoheni me kohë", është thënë në njoftimin e Komunës së Fushë-Kosovës.



Prishtina bëhet gati për rihapjen e shkollave

Prishtinë, 10 shtator (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka thënë se, pas vendimit të Ministrisë së Arsimit që të rihapen shkollat, prioritet për komunën që drejton mbetet mbrojtja e shëndetit të të gjithëve, në veçanti e fëmijëve. Ahmeti të enjten ka qëndruar në shkollën "Dardania", ku është pranuar një donacion me pako higjienike dhe çanta me mjete mbrojtëse për fëmijët, për përgatitjen e rinisjes së mësimi. "Po bëhemi gati për t'i nisur ditët e para në shkollë. Falënderojmë UNICEF-in dhe USAID-in për donacionin për 39 shkollat, ashtu që fëmijët e Prishtinës të kthehen të sigurt në shkollë", ka shkruar Ahmeti në llogarinë e vet në "Facebook".



Per Bekim Fehmiu
difficile liberarsi
del personaggio che
l'ha reso celebre

ULISSE SI PREPARA A DIVENTARE RUBIROSA

di Gianni di Giovanni

M Sta girando un film sulla vita del famoso play-boy: un'occasione eccezionale per conquistare il successo negli Stati Uniti dove vogliono lanciargli come «il brutto che piace alle donne». Avrà accanto attori famosi, da Ernest Borgnine a Olivia De Havilland. Eppure si sente ancora sentimentalmente legato all'eroe omerico

Un bravo ragazzo

Il film "Ulisse" di Lewis Gilbert è un'opera d'arte che si prepara a diventare un classico. Il regista, che ha lavorato con i grandi nomi del cinema, ha voluto raccontare la storia di un uomo che si è trasformato in un eroe. Bekim Fehmiu, che ha interpretato il ruolo di Ulisse, è un attore di grande talento che ha saputo dare vita a un personaggio complesso e affascinante. Il film è una grande occasione per il pubblico italiano, che ha sempre apprezzato le opere di questo grande regista.

Sta girando un film sulla vita del famoso play-boy: un'occasione eccezionale per conquistare il successo negli Stati Uniti dove vogliono lanciargli come «il brutto che piace alle donne». Avrà accanto attori famosi, da Ernest Borgnine a Olivia De Havilland. Eppure si sente ancora sentimentalmente legato all'eroe omerico



Bekim Fehmiu fotografato a Roma, dove si gira il film. Per poter studiare convenientemente in Inghilterra, l'attore partecipa al programma di stage a Londra. Sono le scene di preparazione della regia

Il film "Ulisse" di Lewis Gilbert è un'opera d'arte che si prepara a diventare un classico. Il regista, che ha lavorato con i grandi nomi del cinema, ha voluto raccontare la storia di un uomo che si è trasformato in un eroe. Bekim Fehmiu, che ha interpretato il ruolo di Ulisse, è un attore di grande talento che ha saputo dare vita a un personaggio complesso e affascinante. Il film è una grande occasione per il pubblico italiano, che ha sempre apprezzato le opere di questo grande regista.

Un grande

Il film "Ulisse" di Lewis Gilbert è un'opera d'arte che si prepara a diventare un classico. Il regista, che ha lavorato con i grandi nomi del cinema, ha voluto raccontare la storia di un uomo che si è trasformato in un eroe. Bekim Fehmiu, che ha interpretato il ruolo di Ulisse, è un attore di grande talento che ha saputo dare vita a un personaggio complesso e affascinante. Il film è una grande occasione per il pubblico italiano, che ha sempre apprezzato le opere di questo grande regista.

Lewis Gilbert per Bekim Fehmiu: Egërsira që u pëlqen grave!

“Radiocorriere”, më 17 gusht të 1968, në faqet 34-35 ka publikuar një shkrim të gazetarit Gianni di Giovanni në lidhje me marrëdhënien speciale të regjisorit Lewis Gilbert me Bekim Fehmiu, gjatë xhirimeve të filmit “Aventurierët”. Shkrimi është si më poshtë.

Ai është duke xhiruar një film mbi jetën e plejbojit të famshëm: një mundësi e jashtëzakonshme për të arritur sukses në Shtetet e Bashkuara ku ata duan ta lansojnë atë si “egërsira që u pëlqen grave”. Ai do të ketë përkrah aktorë të njohur, nga Ernest Borgnine te Olivia De Havilland. Megjithatë, ende ndihet i lidhur sentimentalisht me heroin homerik.

“Ai është i çmendur”, bërtiti regjisorit Lewis Gilbert, tani jashtë shpresës së Zotit, “ai është një i çmendur, po ju them”. Sekretarët e produksionit, zyrtarët e shtypit, ndihmësit e drejtorëve tundën kokën në shenjë pranimi. Por, regjisorit Lewis Gilbert tha se nuk i interesonte pëlqimi i të tjerëve. Ai tha sërish me një zë të ngjirur: “Nesër e dua, këtu në Romë, të gjallë apo të vdekur. U kuptuam? Po, zotëria ka vendosur se në mendjen e tij është me të vërtetë Uliksi;

televizioni ia ka ngulitur në tru këtë greko-shqiptari-jugosllav, le ta marrë djalli”. I rraskapitur, regjisorit Lewis Gilbert u ul në një kolltuk. Gruaja e tij Hilda u ul në krahun e tij dhe i tha me zë të ulët: “I dashur, mos u bëjë i paduruar. Do të shohësh se do ta gjejnë” dhe i ledhatoi butësisht dorën. Por, burri nuk i kushtoi vëmendje.

“Gjithë faji yt”, shpërtheu ai, “po, zonjë, është i gjithë faji yt. Ti u dashurove marrëzisht me atë djalë. Ah Lewis, ti duhet absolutisht të shohësh atë film, kjo është ajo që më the. Djali ka atë hijeshi magnetike (tërheqëse) që u pëlqen grave, ma përsërite këtë. Dhe, unë si një idiot që të dëgjon, të shkoj me ty në atë kinema në Paris, ku kishe parë ‘Mbledhësit e puplave’, të zhytesh në Itali për të lansuar Bekim Fehmiun, Uliksin e televizionit, për një film që do t’i kushtojë produksionit shumë

para. Të mjafton kjo tani.”

Uliksi ka fluturuar sërish dhe bravo kush e gjen. “Po si”, dhe regjisorit amerikan i mbante duart në kokë, sikur t’i kishte plasur kafka, “po si? Unë e dërgoj atë në Londër për të mësuar anglisht, kësaj race fshatare, dhe çfarë bën ai? Ai largohet dhe nuk e di më se ku ka shkuar. Unë e pres atë që prej tre muajsh dhe nuk jam aspak i gatshëm ta pres, duke endur kanavacën për njëzet vjet si Penelopa. Producentët e mi, producentët e filmit, nuk kanë durimin e personazheve të Homerit. Ata njerëz ia mbështjellin leckën rreth qafës, për ta mbytur”.

Për një kohë të gjatë britmat e regjisorit bënin që muret e kartonit të teatrit të dridheshin, pastaj pasi po errësohej, ndërsa amerikani i kërkonte falje gruas së tij për ulëritjen, bie zilja e telefonit në dhomën e rezervuar për regjisorin Gilbert në një hotel të madh të Romës.

“Alo Gilbert!”. Ishte Londra në telefon: “E gjetëm. Po sonte, me pak fjalë, vetëm tani, në një pub. Si thua? Po, ai është pak i hutuar, por me pak fjalë ende qëndron në këmbë. A doni të dini se çfarë ka bërë? Epo mund të mos e besoni, por Bekimi e ka kaluar gjithë këtë kohë pa marrë as edhe një orë të vetme leksioni anglishteje. Jo, Lewis mos bërtit,

dëgjo. Ai ka bërë xhiro rreth Londrës tërë ditën, për të mësuar të gjitha nuancat e gjuhës. Po, po, pas gjithë kësaj Uliksi ynë është një djalë i mire”.

Disa ditë më vonë, në Cinecittà, ndodhi ky rit. “Ju nuk jeni më Uliksi, harrojeni atë”, tha regjisorit, duke i dhënë goditjen e parë të gërshtëve mjekrës së zezë e të trashë që akoma zburonte fytyrën e heroit homerik të ekraneve të televizionit italian. “Dhe, diçka tjetër Beky: nga ky moment emri juaj nuk është më Fehmiu, një emër që amerikanët kurrë nuk do të ishin në gjendje ta shqiptonin, por Feymu, Beky Feymu: është e qartë?”, Feymu i ri, tani pa flokë, tund kokën në shenjë pranimi. “Mirë, në rregull unë do të bëj siç thua ti”. Dhe, sigurisht që nuk mund ta kishte kuptuar në atë moment që shpesh roli e përcaktonte aktorin deri në pikën që e bën atë të identifikohet plotësisht me karakterin që i dha jetë, në skenë, në ekran apo para kamerave. “Beky”, përgjigjen në Cinecittà ndaj atyre që pyesin për të, “Beky, dhe kush është ky Beky? Ah, doni Uliksin e televizionit? Dhe po, natyrisht që unë e njoh atë, drej. Shko pak më tej, po lexon (përsërit) pjesën”.

Bekimi kthehet nga prapa, i përkulur mbi një skenar, por

përgjigjet menjëherë, pothuajse automatikisht: “Po, unë jam Uliksi”. Ai bën një gjest me dorën e tij, buzëqesh dhe i shkel syrin regjisorit. “Nëse ky atje më dëgjon, më vret. Vetëm këtë mëngjes ai më tha: Beky, për publikun italian ju jeni dikush, në rregull, por për publikun amerikan jeni më pak se zero, një i panjohur. Por, është më mirë në këtë mënyrë, e di? Sepse unë do të të lansoj me këtë parullë: Beky, egërsira që pëlqejnë gratë. Eh, çfarë mendon?”

Fehmiu hedh skenarin e filmit dhe bëhet i gjallë, duke bërë disa lëvizje. “Kini parasysh, unë nuk i jap goditje fatit dhe nëse ata duan të më lansojnë në Amerikë si James Dean i viteve shtatëdhjetë, unë them: në rregull. Por, unë nuk mund të ndryshoj brenda natës, kjo nuk mundet. Unë nuk jam kukull. Ata thonë se Uliksi përfundimisht do të më kushtëzojë dhe unë përgjigjem: me pak fjalë, unë u diplomova në shkollën e Artit Dramatik të Beogradit duke luajtur pjesën e Uliksit, pata suksesin më të madh në jetën time duke luajtur Uliksin në televizion, çfarë duhet të bëj tani, të harroj që kam luajtur shumë teatër grek para se të mbërrija në kinema? Ata vazhdojnë të më thonë se në këtë film do të kem përkrah meje aktorët Candice Bergen, Olivia De

Havilland, Ernest Borgnine, James Mason, Charles Aznavour dhe Rossano Brazzi. Unë përgjigjem se jam i nderuar dhe i lumtur, dhe e them këtë pa ironi, e kundërta nuk do të ishte mirë. Të luash lojën aventureske të një plejboji të stilit të lartë si Porfirio Rubirosa para kamerës, nuk është punë e vogël. Por, për sa kohë që jam në Itali, unë mbetem romantikisht i lidhur me atë personazh që më zbuloi para miliona spektatorëve. Jo, jo, reagimi im nuk është sentimentalizëm, mbase është realizëm, mbase mirënjohje: le ta quajmë atë që na pëlqen por pse duhet të harroj papritur suksesin tim?" Polemika është ndoshta pak e tepruar dhe duket vërtet falas nëse nuk merrni parasysh dramën e këtij njeriu që në këto ditë duhet të heqë qafe me forcë jo vetëm personazhin që e bëri atë një aktor të suksesshëm, por edhe të një skeme mëndore në të cilën deri tani u përshtat me lehtësi. Përballë gjykimin të publikut amerikan, duke mos zhgënjyer pritjet e regjisorit dhe producentëve: këto janë problemet që shqetësojnë ish-Uliksin dhe e mbajnë atë të tensionuar dhe nervoz. Një ankh që aktori nuk dëshiron t'i rrëfej as vetes. "Nuk i mbyll sytë ndaj suksesit. Unë kam lindur i varfër, në Serajevë, prindërit e mi ishin nga Prizreni, një fshat shqiptar, në atë kohë. Unë isha i shtati nga tetë fëmijët. Ata më thirrën Bekim, që përkthehet Benedetto, dhe si djalosh thanë se kisha djallin në trupin tim. Por, fakti është që unë doja të dilja nga fshati dhe mjerimi dhe kur në vend erdhi një kompani, vendosa që me çdo kusht të bëhesha aktor dhe ia dola mbanë. Kam punuar shumë por gjithçka më ka shkuar mirë. Tani më intereson të jem vetvetja." Shihet se Fehmiu po reciton tani. Suksesi ka rëndësi për të, me të vërtetë: ai e nuhat atë, e sheh atë, e ndjek me kokëfortësi. Ai përsërit me krenari gjykimin që Lewis ka për të: "Ai është aktori më profesional dhe më i disiplinuar nga të rinjtë që kam takuar ndonjëherë. Jam i bindur që do të ketë një sukses të qëndrueshëm në ekran. Feymu është lloji i njeriut modern, me gjallëri dhe forcë të madhe karakteri, por me një nuancë mërzie dhe vetmie që ndjen trishtim. Përmbledhja e gjithë kësaj së bashku në një personazh filmi është e mundur vetëm për një aktor të shkëlqyeshëm dhe unë besoj fuqimisht se Feymu është ky aktor". Ndoshta regjisorin nuk vuri re një gjë: që nën lëkurën e një njeriu të vrazhdë, burrit të fortë, Uliksit të guximshëm, është një i ri i qetë, i ndrojtur, i etur për t'u ndjekur, kuptuar, dëgjuar.

/Darsiani/

Strategjitë për manipulim publik

Nga: Noam CHOMSKY
Përgatiti: Ilir SECI

1. Strategjia e shpërqendrimin

Elementi parësor i kontrollit shoqëror është strategjia e shpërqendrimin, (zhvendosjes së vëmendjes), strategji e cila konsiston në devijimin e vëmendjes së publikut nga problemet madhore dhe nga ndryshimet e vendosura nga elitat politike, përmes teknikës së përmbytjes ose vërshimeve me shpërqendrim të vazhdueshme dhe informacione të parëndësishme.

2. Krijoni probleme e mbasandej ofroni zgjidhje

Kjo metodë quhet gjithashtu "problem-reagim-zgjidhje". "Krijoni një problem, një "situatë", për të cilën shkaktohet një reagim në audiencë, ky është kryesori i hapave që dëshironi të ndërmerri. Për shembull: le të shpaloset dhe të intensifikohet dhuna urbane, ose të organizohen sulme të përgjakshme, në mënyrë që publiku të bëjë vetë ligjet dhe politikat e sigurisë, në dobi të aplikantit dhe në dëm të lirisë. Ose: krijoni një krizë

ekonomike për me pranua si një të keqe të domosdoshme reduktimin e të drejtave sociale dhe çmontimin e shërbimeve publike.

3. Strategjia e graduals

Për me e bërë të pranueshme një masë ose vendim të papranueshëm, duhet me e zbatua atë gradualisht, pak nga pak, për vite me radhë.

4. Strategjia e shtyrjes

Një mënyrë tjetër për ta pranuar një vendim jopopullor është me e paraqitë atë si "të dhimbshëm, por të domosdoshëm", duke fituar aprovimin e publikut, në kohën e aplikimit për t'u zbatuar në të ardhmen. Është më e lehtë të pranohet një sakrificë e ardhshme sesa një masakër e menjëherëshme. Së pari, sepse përpjekja nuk zbatohet menjëherë. Mbasandej, për shkak se publiku, masa, është gjithmonë e prirë naivisht të supozojë se "gjithçka do të jetë ma mirë nesër" dhe se flijimi i kërkuar mund të shmanget. Kjo i jep publikut më shumë kohë për t'u mësuar me idenë e ndryshimit dhe ta pranojë atë me dorëheqje kur të vijë koha.

5. Komunikimi me publikun sikur të ishin fëmijë

Nëse dikush i drejtohet një personi sikur të ishte dymbëdhjetë vjeç a ma i vogël, atëherë, bazuar në sugjerueshmërinë, ata me siguri do të prirën për me u përgjigj ose reagoar si një personi që është dymbëdhjetë vjeç ose ma pak.

6. Përdorni aspektin emocional shumë më tepër sesa reflektimin

Shfrytëzimi i emocionit është një teknikë klasike për të provokuar një qark të shkurtë në një analizë racionale. Për ma tepër, përdorimi i regjistrit emocional mundëson me e hapë derën e hyrjes tek e pavetëdijshme, për të implementuar ose injektuar ide, dëshira... frikë mbas frike.

7. Mbajtja e publikut në injorancë dhe mediokritet

Duke e bërë publikun të paafte për të kuptuar metodat e përdorura për kontrollin e tyre. Niveli i arsimit që u jepet klasave të ulëta shoqërore duhet me qenë sa më i dobët dhe sa ma mediokër që të jetë e mundur.

8. Stimulimi i publikut për t'u pajtuar me mediokritetin

Ta bësh publikun të besojë se është në modë me qenë budallenj, vulgarë dhe injorantë.


9. Përforcimi i kompleksit të vetëfajësimit

Ta bësh individin të besojë se ai është i vetmi faktor për fatkeqësinë e tij. Pra, në vend që me u rebelua kundër sistemit ekonomik, individi zhvlerëson vetveten dhe fajëson veten e tij, gjë e cila nga ana tjetër krijon një gjendje depresive, një nga efektet e së cilës është frenimi i veprimit të tij. Dhe, pa veprim nuk ka revolucion.

10. Njohja e individëve më mirë sesa e njohin ata veten

Falë biologjisë, neurobiologjisë dhe psikologjisë së aplikuar, sistemi ka gëzuar një njohuri të përparuar të qenies njerëzore, si të formës fizike ashtu edhe asaj psikike. Sistemi ka arritë me e njoftë individin e zakonshëm ma mirë sesa e njeh ai veten. Kjo do me thanë se, në shumicën e rasteve, sistemi ushtron kontroll të madh dhe fuqi të madhe mbi individët, më të madhe se sa kontrolli që ushtron individi mbi veten e tij. / Telegraf





**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Prishtina bën edhe dy goditje të mëdha në afatin kalimtar

FC Prishtina ka bërë dy goditje të mëdha në afatin kalimtar, pasi nga Hajduku i ka transferuar në formë huazimi mbrojtësin Lombard Dellova dhe portierin kroat Ivan Jeliç. Ky i fundit është 22-vjeçar dhe ka përvojë në kampionatin kroat dhe atë sloven, kurse mbrojtësi Devolla në të kaluarën ishte pjesë e Lirisë së Prizrenit

“Epoka e re”

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Fituesja e Kupës së Kosovës në futboll, FC Prishtina, ka qenë mjaft aktive të enjten pasi ka prezantuar dy transferimet e reja për edicionin 2020/2021. Klubi kryeqytetas i Kosovës bëri me dije se anëtar i Përfaqësueses së Kosovës U21, Lombard Dellova, është përfundim për kampionatin e ri. Qendërmbrojtësi i lindur në Krushë dhe ish-anëtar i Lirisë së Prizrenit, i transferuar në Hajduk para dy vjetësh, Lombard Dellova do të ndihmojë në formë huazimi skuadrën kryeqytetase për edicionin 2020/21.

Dellova, 21-vjeçar, ka qenë pjesë e rregullt e 18-s së parë në skuadrën e njohur kroate Hajduk. Me Hajduk II ka zhvilluar pothuajse të gjitha ndeshjet në Ligën e Parë. “Ardhjen te Prishtina e konsideroj një hap trampoline duke pasur parasysh se në Hajduk nuk kisha minuta aq sa dëshiroja, megjithëse isha në 18-she në shumicën e ndeshjeve. Por, mua më duhen ndeshje në këmbët e mia. Jam futbollist i ri dhe duke besuar shumë se me Prishtinën do të jetë ndihmë e dyanshme, vendosa pa hezitim të jem pjesë e skuadrës. Shpresojmë t'i arrijmë objektivat. Nuk jam i panjohuri për ekipin, për klubin dhe nuk ka ndryshuar aq shumë prej kohës kur me Lirinë te trajneri Shkëmbi kisha debutuar kundër Prishtinës. T'ju them të drejtën, mezi pres të paraqitem, sidomos këtu në 'Fadil Vokrri', ku para ca ditësh edhe



debutova në stadiumin e rinovuar kundër Anglisë U21”, ka thënë Devolla.

Përfundimi i dytë i skuadrës “bardhekalitër” është portieri Ivan Jeliç nga Kroacia. Pavarësisht asaj se Englant Haxhio dhe Alban Muçiqi kanë vazhduar javë më parë kontratat me klubin, kryeqytetasit kanë vepruar duke e siguruar edhe portierin e tretë. 22-vjeçari ka luajtur për disa skuadra kroate, përfshirë edhe RNK Split. Së fundmi ka mbrojtur ngjyrat e skuadrës së Ligës së Parë të Sllovenisë, NK Krsko. “Të jem i singjertë, nuk kam menduar ndonjëherë për Prishtinën.

Me ndihmën e menaxherëve shumë shpejt kemi arritur marrëveshje dhe ja tani ndodhem këtu. Ndihem mirë që bëhem pjesë e klubit më të madh në Kosovë. Është një hap i madh në karrierën time”, ka thënë Jeliç për faqen zyrtare të Prishtinës. “Familja ishte pak skeptike për shkak të 'koronës', por babai menjëherë më tregoi se bëhet fjalë për një klub të madh. Pastaj u interesova më shumë nëpërmjet shokëve dhe që të gjithë njëzëri më sugjeruan që pa hezitim ta pranoj këtë sfidë të re dhe jam i kënaqur që tani ndodhem në mjedisin e ri”, ka shtuar Jeliç.

SHKURT

Bremeni e kërkon Vocën

Mesfushori i Kosovës, Idriz Voca, që luan me sukses te Luzerni, po kërkohet nga klubi gjerman Werder Bremen. Forma e mirë e Vocës ka bërë që klubi aktual i Milot Rashicës ta shfaqë interesimin për transferimin e tij në këtë afat kalimtar. Transferimi i 23-vjeçarit në Gjermani duket shumë i mundshëm, ani pse ai ka kontratë me skuadrën zvicerane edhe për një vit tjetër.

Girona interesohet për portierin Muriq

Skuadra e Gironës është e interesuar për transferimin e portierit të Kosovës, Arijanet Muriq. Girona, që është pjesë e La Ligës 2, është klub në pronësi të City Football Groupit, që ka nën menaxhim edhe Manchester Cityn. Pikërisht Girona mund të huazojë dy lojtarë nga ky klub, ku përveç Pablo Morenos edhe portieri Arijanet Muriq mund të kalojë si huazim. Muriqi është nën kontratë me Manchester Cityn, ndërsa ishte i huazuar fillimisht në NAC Breda e më pas në Nottingham Forest.

Trajnerë të njohur do të ligjërojnë në klinikën për trajnerë e Kosovës

Shoqata e Trajnerëve e Basketbollit e Kosovës në bashkëpunim me Federatën e Basketbollit të Kosovës, për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19, njofton se klinika e sivjetme për trajnerë do të zhvillohet në formatin online më 26 dhe 27 shtator. Për shkak se organizimi i klinikës dallon nga vitet e mëparshme, shumë shpejt do të dihet për mënyrën e përcjelljes së klinikës, kushteve të licencimit dhe kotizimit për edicionin garues 2020-2021. “Këtë vit do t'i kemi katër trajnerë të nivelit të lartë, të cilët do t'i ndajnë përvojat dhe sukseset e tyre të mëdha. Trajnerët që do të ligjërojnë janë: Don Showalter, drejtor i zhvillimit të basketbollistëve të rinj pranë USA BASKETBALL, Mike Kelly, trajner i Cairns Taipans (Australi), trajner i vitit 2020 në Australi, Cody Toppert, ndihmëstrajner në Universitetin e Memphisit dhe Roberto Iezzi, trajner kondicional i Hapoel Jerusalem”, thuhet në njoftimin e FBK-së.

Kuka: Klubet po shuhen, institucionet duhet të reagojnë

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Trajneri i Kosovës në xhudo, Driton Kuka, ka thënë se klubet po shuhen dita-ditës si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia Covid-19. Ai u ka bërë thirrje autoriteteve që të reflektojnë karshi klubeve, karshi aktiviteteve e garave për të rinj. “Ringjallja e klubeve sportive në Kosovë s'po ndodh.

Në pritje të premtimeve për rimëkëmbjen e sportit asgjë s'po ndodh ende. Klubet, e sidomos shkollat bazë të sporteve në Kosovë, për shkak të pandemisë po pësojnë në mënyrë drastike. Klubet po shuhen dita-ditës si pasojë e situatës së krijuar. Shtatori, muaji kur sporti ngrehet me anëtarë të rinj, tashmë

shumicën e tyre i gjen të mbyllura e pa aktivitete sportive. Ministria, KOK-u bashkë me federatat, por edhe drejtoritë e sporteve në komuna reflektoni karshi klubeve, karshi aktiviteteve e garave për të rinj. Ta ringjallim sportin!”, ka shkruar Kuka në profilin e vet në “Facebook”.



Rrahmani: Tifozët kërkojnë që ta mposhtim Juventusin

NAPOLI, 10 SHTATOR - Amir Rrahmani ditë më parë i është bashkuar skuadrës së Napolit. Në një intervistë për "Radio Kiss Kiss", mbrojtësi i Kosovës ka zbuluar se tifozët e Napolit kanë kërkuar që të mposhtet Juventusin.

"Shpresojmë që ta fitojmë Ligën e Evropës. Kemi gjithçka për t'i shkuar deri në fund. Kemi lojtarë për të arritur gjithçka. Mund të bëjmë rotacion. Fansat më kërkojnë ta mund Juventusin, t'i fitoj Kupën dhe Ligën e Evropës.

Unë mund të pretoj se do të punoj shumë për ta mundur Juventusin dhe gjithë ekipet e tjerë", ka thënë Rrahmani, i cili ka zbuluar se sistemi i lojës me katër mbrojtës i përshtatet më shumë. "Unë luaj më mirë me katër mbrojtës.

Me tre kam luajtur vetëm një vit në Kroaci dhe sezonin e shkuar te Hellas Verona. Ndiem më mirë me katër. Është pozicioni im natyral. Pastaj varet gjithçka nga dëshira e trajnerit", ka shtuar kapiteni i Kosovës.



Laçi: Gjithë jetën e prisja debutimin në Kombëtare

TIRANË, 10 SHTATOR - Qazim Laçi debutoi në Kombëtaren e Shqipërisë. Mesfushori që aktivizohet në Francë te Ajaccio ka dhënë një intervistë për faqen e klubit, duke treguar edhe emocionet e këtij aktivizimi. "Kisha gjithë jetën që e prisja debutimin me kombëtaren e madhe, teksa isha aktivizuar me të gjitha përfaqësueset e moshave më parë. Momenti erdhi dhe është krenari e madhe që mbroj fanellën e kombëtares së vendit tim. Një shpërblim për punën time të madhe dhe përparimin e bërë. Provova shumë emocione gjatë ndeshjes me Lituaninë", ka thënë Laçi. U ndjeva shumë krenar që e nisa si titullar, por jam disi i trishtuar për faktin se nuk e fituam dot ndeshjen.



Ajaccio? Nuk e kemi nisur kampionatin ashtu siç donim. Por, ka qenë një situatë e vështirë, që lidhet edhe me fundin e sezonit të kaluar. Në

ekip janë afruar disa lojtarë të rinj dhe jam i sigurt se me kalimin e kohës do të rikthehem te fitoret", ka shtuar Laçi.

Toronto mposhti Bostonin pas dy shtesave, Clippersat u afrohen finaleve



KONFERENCA E LINDJES - GJYSMËFINALE "PLAY-OFF"

Milwaukee - Miami (1-4)
Boston - Toronto 122-125 (3-3)

KONFERENCA E PERËNDIMIT - GJYSMËFINALE "PLAY-OFF"

Clippers - Denver 96-85 (3-1)
Lakers - Houston (2-1)

ORLANDO, 10 SHTATOR - Ekipi i Clippersave u afrohet finaleve të "play-off"-it në Konferencën e Perëndimit, pas fitores 96-85 ndaj Denverit, duke udhëhequr 3-1 serinë e takimeve mes tyre. Fitore e merituar e Clippersave, që dominua në ndeshje që në fillim, duke treguar epërsi në fushë. Leonardo me 30 pikë e 11 rebounde ishte shënuesi më i mirë për Clippersat, ndërsa për Denverin u dallua Jokiç me 26 pikë e 11 rebounde.

Ekulibër i plotë në Lindje, ku barazohet në 3-3 seria e ndeshjeve gjysmëfinale mes Bostonit dhe Torontos. Skuadra kanadeze fitoi me rezultat 125-122 ndaj Celticsit pas dy kohëve shtesë, në një sfidë me shumë emocione. Kyle Lowry realizoi 33 pikë për Toronton, duke qenë lider për kanadezët, mbështetur edhe nga Powell me 23 pikë e VanVleet me 21. Për Bostonin, Brown e Tatum realizuan 60 pikë së bashku.

SHKURT

Veteli sezonin e ardhshëm garon me Aston Martinin

Piloti gjerman Sebastian Vettel katër herë kampion bote në Formula 1 do të pilotojë me makinën Aston Martin sezonin e ardhshëm. Piloti aktual i Ferrarit do të largohet nga makina italiane në fund të këtij sezoni dhe ka vendosur të garojë me Aston Martin. Për Vettelin kjo është makina e pestë në karrierën e tij në Formula 1: BMW Sauber, Toro Rosso, Red Bull, Ferrari e sezonin e ardhshëm Aston Martin. Veteli largohet nga Ferrari pas 6 sezonesh, ku arriti 14 fitore, por nuk mundi të shpallet kampion bote.

Presidenti i Napolit infektohet me Covid-19

Presidenti i Napolit, Aurelio De Laurentiis, është pozitiv për Covid-19. Napoli ka konfirmuar se presidenti i saj është infektuar me koronavirus. "Napoli komunikon se presidenti Aurelio De Laurentiis ka rezultuar pozitiv për Covid-19", thuhet në njoftimin e klubit.

Griezmann: Raporti im me Messin, sikurse me Mbappen

Sezoni i fundit nuk ka qenë pozitiv për Antoine Griezmann. Kampioni i botës la Atletico Madridin për Barcelonën dhe shënoi 15 gola në të gjithë kompeticionet me ekipin katalanas. Shumë është përfolur për mosarritjen e ndërtimit të një raporti të mirë me Leo Messin, teksa sulmuesi francez flet rreth kësaj çështje për RTL. "Raporti im me Leo Messin është njësoj si ai që kisha në fillim me Kylian Mbappe. Kishim disa probleme në fillim në kombëtare me Kylian, na u desh kohë t'i sistemonim gjërat mes nesh. Mendoj se raporti im me Leon do të përmirësohet me kalimin e kohës. Jam i sigurt", ka deklaruar Griezmann.

Nainggolani qëndron tek Interi

Radja Nainggolan nuk do ta veshë fanellën e Cagliarit sezonin e ardhshëm. Mesfushori belg, që kohët e fundit është kthyer tek Interi pas një sezoni në formë huazimi në Sardenjë, nuk do të rikthehet në klubin ku spikati fillimisht në Serinë A, pavarësisht se ditë e fundit ishin shtuar zërat mbi vullnetin e palëve për t'i bashkuar rrugët. Lajmin e ka dhënë presidenti i Cagliarit, Tommaso Giulini që, pas një takimi me drejtuesit e Interit, u shpreh: "Takimi nuk shkoi mirë. Është e pamundur të kthehet te Cagliari. Besoj se do të qëndrojë në Milano. Duan ta mbajnë".

Të shtunën fillon La Liga

Këtë fundjavë do të rinisë futbolli... "i vërtetë". Jo vetëm Premierë Liga, por edhe skuadrat e La Ligas do të zbresin në fushë. Kampionati spanjoll për sezonin 2020-21 do të debutojë me sfidën hapëse Eibar-Celta Vigo, të shtunën nga ora 16:00. Por, nuk do të ketë më ndeshje të premtën dhe të hënën. Federata Spanjolle e Futbollit (RFEF), gjatë një takimi me Ligën, ka marrë një vendim në prag të sezonit të ri dhe pikërisht e shtuna dhe e diela, përveç mesjavës, do të ketë ndeshje në program. Granada-Athletic Bilbao ishte programuar si takimi hapës i sezonit 2020/2021, por është shtyrë nga e premtja në mbrëmje për në ditën e shtunë (18:30). Një vendim që gëzon tifozët iberikë, të cilët nuk i preferonin përballjet e ditëve të premtë dhe të hënë.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
MUNICIPALITY OF LIPJAN
SKUPŠTINA LIPLJAN

DREJTORATI PER PLANIFIKIM, URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Bazuar në nenin 4, neni 11 dhe neni 20 të Ligjit për Planifikim Hapësinor 04/L-174, neni 5, 6, 7 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr.05/2014 për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procedurat e pjesëmarrjes së publikut në planifikimin hapësinor, Vendimin e Kuvendit të Komunës së Lipjanit Nr.15-350-32607 dt.30.07.2020 për vënie në shqyrtim publik të Projekt dokumentit Harta Zonale e Komunës së Lipjanit Nr.15-350-32607 dt.30.07.2020, Komuna e Lipjanit - Drejtorati për Planifikim Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit shpallë:

NJOFTIM PËR SHQYRTIM PUBLIK

Projekt dokumenti - Harta Zonale e Komunës së Lipjanit 2020-2028

Komuna e Lipjanit fton qytetarët, sektorin publik dhe privat, ekspertët OJQ-të dhe të gjithë të interesuarit që të marrin pjesë në procesin e Shqyrtimit Publik të Projekt dokumentit - Harta Zonale e Komunës së Lipjanit 2020-2028 dhe Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor të HZK.

Shqyrtimi publik Projekt dokumenti - Harta Zonale e Komunës së Lipjanit 2020-2028 dhe Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor të HZK do të zhvillohet në periudhë prej 30 ditësh nga data 19 shtator 2020 deri më 19 tetor 2020, çdo ditë pune nga ora 10:00 deri në orën 14:00, në ndërtesën e Komunës së Lipjanit – Salla e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, rruga "Shqipëria" Nr.28 si dhe në web faqen zyrtare të Komunës së Lipjanit <https://kk.rks-gov.net/lipjan/>

Kundërshtimet, komentet apo syqjerimet në Projekt dokumentin - Harta Zonale e Komunës së Lipjanit 2020-2028 mund të paraqiten në formë të shkruar gjatë periudhës së shqyrtimit publik deri më 19 tetor dhe i adresohen Drejtoratit për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit përmes Qendrës për Shërbim të qytetarëve, Kati përdhësë, Sporteli Nr.2 dhe Nr.3, përmes postës ose në email: DPUMM.lipjan@rks-gov.net.

Materiali në kopje fizike dhe sqarimet nga stafi do të zhvillohen në Ndërtesën e Komunës së Lipjanit - Salla e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, ndërsa Kundërshtimet, komentet apo syqjerimet mund të shkruhen në librin e prezentuar.

Prezantimet publike të Projekt dokumentit - Harta Zonale e Komunës së Lipjanit 2020-2028, do të mbahen sipas rregullave të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë, dhe si në vijim:

Zona urbane - Qyteti i Lipjanit :

- Zonat Urbane: "Qendra", "Zona Urbane Perëndimore -1 (ZUP-1)", ZUP-2, ZUL-8, ZUL-9" të mërkurën 23.09.2020 me fillim në orën 11:00 në Ndërtesën e Administratës Komunale – Salla e Mbledhjeve të Kuvendit, në Lipjan.
- Zonat Urbane: Zona Urbane Lindore ZUL-4, ZUL-6, ZU7-7, të premten më 25.09.2020 me fillim në orën 11:00 në Ndërtesën e Administratës Komunale – Salla e Mbledhjeve të Kuvendit, në Lipjan
- Zonat Urbane: Zona Urbane Lindore ZUL-2, ZUL-3, ZUP-5, dhe ZUL-5 të hënën 28.09.2020 me fillim në orën 11:00 në Ndërtesën e Administratës Komunale – Salla e Mbledhjeve të Kuvendit,
- Zonat Urbane: Zona Urbane Lindore ZUL-4, ZUL-6, ZU7-7, të mërkurën më 30.09.2020 me fillim në orën 11:00 në Ndërtesën e Administratës Komunale – Salla e Mbledhjeve të Kuvendit, në Lipjan

Zonat rurale :

Zona perëndimore e Komunës

- Prezentimi do të mbahet në Magurë të hënën më 05.10.2020 me fillim në orën 11:00 në objektin e Qendrës Rinore në Magurë.

Zona lindore e Komunës

- Prezentimi do të mbahet në Gadime të enjten 08.10.2020 me fillim në orën 11:00 në Shkollën Filllore "Zenel Hajdini" në Gadime.

Takimi Publik i Ekipit Komunal për Planifikim do të mbahet pas periudhës së shqyrtimit publik të mërkurën me datë 28 tetor 2020 me fillim në orën 11:00 në Ndërtesën e Administratës Komunale – Salla e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në Lipjan.

Personat fizik dhe përfaqësuesit e personave juridik të cilët kanë paraqitur Kundërshtimet, komentet apo syqjerimet me shkrim gjatë periudhës së shqyrtimit publik mund të marrin pjesë në këtë Takimin publik, në të cilin do të trajtohen dhe informohen për çështjet e prezentuara.

Dokumentet e Prezentuara:

- Harta Zonale e Komunës së Lipjanit 2020-2028
- Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor të HZK .



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
MUNICIPALITY OF LIPJAN
SKUPŠTINA LIPLJAN

DIREKTORAT ZA PLANIRANJE, URBANIZAM I ZAŠTITE SREDINE

Na osnovu člana 4, 11 i član 20 Zakona za Prostorno Planiranje 04/L-174, člana 5, 6, 7 i 8 Administrativno Uputstvo MSPP Br.05/2014 o odgovornostima organa za prostorno planiranje kao i principima i postupcima učešća javnosti u prostornom planiranju, Odluka Skupštine opštine Lipljan Br.15-350-32607 dt.30.07.2020 na javno razmatranje projekt dokumenat Zonalska map Opštine Lipljan Br.15-350-32607 dt.30.07.2020, Opština Lipljan – Direktorata za Planiranje Urbanizam i Zaštite Sredine obavija:

OBAVEŠTENJE ZA JAVNO RAZMATRANJE

Projekt dokumenat – Zonalska Map Opštine Lipljan 2020-2028

Opština Lipljan poziva građane, privatni i privatni, eksperti NVO I svi interesovani da učestvuju na proces Javnog Razmatranja Projekt Dokumenta-Zonalska Map Opštine Lipljan 2020-2028 i Izveštaj o Strateškoj Proceni životnu sredinu ZMO.

Razmatranja Javni Pojekat Dokumenta – Zonalska Map Opštine Lipljan 2020-2028 i izveštaj o strateškoj proceni životnu sredinu ZMK odvijaju se u periodu od 30 dana od dana 19 septembar 2020 do dana 19 oktobra 2020, svaki dan rada od 10:00 časa do 14:00, u objekat Opštine Lipljan – Sala sednice Skupštine Opštine, ulica "Shqipëria" Br.28 kao i na službenoj web sajtu Opštine Lipljan <https://kk.rks-gov.net/lipjan/>

Prigovori, komentari ili sugestije u Nacrtu dokumenta – Zonalska Map Opštine Lipljan 2020-2028 mogu se podneti u pisanom obliku tokom perioda javnog razmatranja do 19 oktobra i da se adresiraju u Direktorata za Planiranje, Urbanizam i Zaštitu preko Centar za Građane Usuge, prizemlje – Sportel Br.2 I Nr.3, preko poste ili email: DPUMM.lipjan@rks-gov.net.

Materijal u fizičkim primercima i pojašnjenja osoblja obaviće se u zgradi opštine Lipljan - Sala sednice Skupštine Opštine, dok primedbe komentare ili sugestija mogu se upisati i knjigi predstavljanja.

Javne rasprave Projekat dokumenata – Zonalske Mape Opštine Lipljan 2020-2028, će se održati preko Uputstva Ministarstva za zdrave, kao što sledi :

Urbana Zona – Grad Lipljan :

- Urbana Zona: "Centar", "Zapadna Urbana Zona -1 (ZUZ-1)", ZUZ-2, IUZ -8, IUZ -9" sreda 23.09.2020 sa početkom 11:00 u Zgradi Opštinske Administracije- Sala Skupštine u Lipljan.
- Urbanske Zone : Istočna Urbana Zona IUZ-4, IUZ -6, ZU7-7, u petak 25.09.2020 sa početkom 11:00 u Zgradi Opštinske Administracije- Sala Skupštine u Lipljan
- Urbanska Zona : Istočna Urbana Zona IUZ -2, IUZ-3, ZUZ-5, i IUZ-5 u ponedeljak 28.09.2020 sa početkom 11:00 u Zgradi Opštinske Administracije- Sala Skupštine u Lipljan.
- Urbanska Zona : Istočna Urbana Zona IUZ -4, IUZ-6, ZU7-7, u sredu 30.09.2020 sa početkom 11:00 u Zgradi Opštinske Administracije- Sala Skupštine u Lipljan.

Ruralne Zone :

Zapadna Zona Opštine

- Rasprave će se održati u Maguri u ponedeljak 05.10.2020 sa početkom u 11:00 u objektu Omladinsko Centra Magure .

Istočna Zona Opštine

- Rasprava će se održati u Gadimlje u četvrtak 08.10.2020 sa početkom u 11:00 Osnovna Škola "Zenel Hajdini" u Gadimlje.

- Javni sastanak Opštinske ekipe za Planiranje će se održati nakon perioda Javne Rasprave u sredu 28 oktobra 2020 sa početkom 11:00 u Zgradi Opštinske Administracije- Sala Skupštine u Lipljan.

Fizička lica i predstavnici pravni lica koji su predstavljali protivljenje, komentara ili sugestije pismeno tokom perioda Javne Rasprave mogu učestvovati na ovom javnom sastanku gde će se raspravljati i informisati.

Predstavljene Dokumentacije:

- Zonalska Mapa Opštine Lipljan 2020-2028
- Izveštaj o strateškoj proceni životnu sredinu ZMO .



Kompania Rajonale e Ujësjesit
Regional Water Supply Company
Regionalna vodovodna kompanija

KOMPANIA RAJONALE E UJESJELLESIT KRU'GJAKOVA' Sh.A. –GJAKOVE Në mbështetje të Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe autorizimeve të dhëna nga Bordi i Drejtorëve me rregulloren për marrjen dhe dhënien me qira të objekteve të KRU'Gjakova'SH.A-Gjakove Shfrytëzimi i hapësirave do të bëhet me qëllim të trajtimit të drejtë, si dhe sigurimit të mundësive më të mira, për të krijuar te hyra, bazuar në rregulloret e brendshme dhe Ligjet në fuqi nxjerr këtë:

Ftesë për ofertim për marrjen me qira të hapësirave për Pikat Arkëtuese për KRU'GJAKOVA "sh.a-Gjakovë.

Kushtet e KRU'Gjakova' sh.a për marrjen e hapësirave me qira per pikat arkëtuese Gjakove, Rahovec.

- Dokumentacioni pronësoro-juridik urbanistik në rregull,
- Nyje sanitare (banje, tualet),
- Dysheme me pllaka, parket, ose laminat
- Vendosje të grilave- parrakeve të sigurisë sipas kërkesës së komisionit
- Ndriqim të mjaftueshem në përputhje me hapësirën e zyrës postare,
- Pa obligime paraprake financiare ndaj Ujësjesit, KEDS dhe shtetshme tjera komunale,
- Njehsor te veqante te energjise elektrike dhe te ujit (ujëmates),
- Hapësire e mjaftueshme në m2 për ushtrimin e veprimtarisë për pika të shitjes,
- Kati përdhës i objektit,
- Kushtet teknike te lokalit/ hapësirës duhet te jene te përshtatshme për veprimtari te shërbimit ;
- Lokacioni i frekuentuar nga qytetaret, afërsia e bizneseve te ndryshme, lokacioni me numër te konsiderueshem te banoreve, afërsia e shkollave, udhëkryqje te rrugëve;

Afati kohor i marrjes me qira në kohëzgjatje prej 1 vit me mundësi vazhdimi

KRITERET E KRU'Gjakova'sh.a-Gjakovë

Të drejtë pjesëmarrje kanë si personat fizik dhe juridik.

Persona fizik duhet të kenë kopjen e letërnjoftimit , vërtetimin nga Gjykata që nuk janë në hetime

Personat juridik duhet të sjellin certifikatën e regjistrimit të biznesit kurse vërtetimi nga Gjykata në emër të Operatorit ekonomik se nuk është në hetime

INFORMATA ADMINISTRATIVE

- Komisioni themeluar nga KRU'Gjakova' sh.a., do të bëjë vlerësimin dhe përzgjedhjen e ofertës më të mirë dhe më të favorshme.
- Obligimet tatimore me rastin e marrjes së hapësirave me qira zbriten sipas Ligjeve në fuqi
- Ofertat duhet të dorëzohen të mbyllura.
- Afati për dorëzimin e ofertave: është deri me datën 25.10.2020 në ora 16:00.
- Vendi i dorëzimit, arkiva e KRU'Gjakova sh.a. Gjakova rr. UÇK nr 7 50000 Gjakove. nr. tel 0390320503



NJOFTIM

Licencimi i Aktivitetit të Furnizimit me Shumicë (Tregtimit) të Energjisë Elektrike në Kosovë

BINDI INTEGRATED SERVICES SH.P.K, me adresë Rr. 17 shkurti Kati 5 Model Slovenia H1., Fushë Kosovë, Republika e Kosovës, në pajtim me Nenin 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Rregulla ZRRE/Nr 07/2017), nëpërmjet kësaj **NJOFTON** palët e interesit se ka aplikuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji për licencim të aktivitetit të **Furnizimit me Shumicë (Tregtimit) të energjisë elektrike në Kosovë**. Aplikacioni për licencim të këtij aktiviteti me të gjitha dokumentet relevante, është shqyrtuar nga punonjës të Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe konsiderohet në fazën finale për vendimmarrje.

Licencimi i furnizimit me shumicë (tregtimit) të energjisë elektrike i ndërmarrjes **BINDI INTEGRATED SERVICES SH.P.K** përveç tjerash do të përbëjë:

- Territori i mbuluar nga Licenca është Republika e Kosovës.
- I licencuari ka të drejtë të blejë kapacitete dhe energji elektrike nga prodhuesit me çmime të parregulluara
- blejë dhe shes kapacitete dhe energji elektrike nga furnizuesit tjerë me çmime të parregulluara;
- shes kapacitete dhe energji elektrike furnizuesve tjerë me çmim të pa-rregulluar; dhe
- transitojë, importojë dhe eksportojë kapacitete dhe energji elektrike.

I licencuari mund të kryejë aktivitetin e furnizimit me shumicë (tregtimit) të energjisë elektrike në pajtim me dispozitat e Licencës së lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji, Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë dhe legjisllacionit tjetër në fuqi.

Të gjithë palët e interesuara mund të kundërshtojnë dhënien e kësaj licence brenda tetë (8) ditësh kalendarike, nga data e shpalljes së këtij njoftimi në gazetë. Kundërshtimi/ankesa mund të bëhet në adresën: Zyra e Rregullatorit për Energji, Rr. "Dervish Rozhaja", Nr. 12, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës; e-mail: hrexhaj@ero-ks.org; Tel.038247615/118.

"Bindi Integrated Services" sh.p.k

Adresa: Rr. 17 Shkurti, Kati 3, H1., B 26-4

Fushë Kosovë.

Tel: + 383 (0) 38 244 144

Mob: + 383 43 727 456

Email: info@bindi.al

Ledian.taci@bindi.al

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

Kërkoj një pastruese për shtëpi. Shtëpi është në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Informatat në tel: 045-336-731

► "DP LUX" L.L.C shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 71356590.

► Lëshoj banës me qira në Prishtinë, banesa është në qendër, përballë EULEX-it rruga "Luan Haradinaj". Banesa është 80m2 e mobiluar me nxehtë qendrore. Çmimi 250 Euro. Tel: 044-171-328.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit më qira. Lokalit është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokalit gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

